



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Bashkinë Fushë Arrëz”.**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**  
**Mbi**  
**“Auditimin financiar dhe të**  
**Përputhshmërisë në Bashkinë Fushë Arrëz”**

**Tiranë, 2021**

## 📖 PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</b>	<b>4 – 13</b>
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	<b>13 - 16</b>
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>16 – 23</b>
	a. Objekti i auditimit	
	b. Qëllimi i auditimit.....	
	c. Identifikimi i çështjes.....	
	d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	
	e. Përgjegjësitë e Audituesve.....	
	f. Kriteret e vlerësimit .....	
	g. Standardet e auditimit.....	
	h. Metodatat e auditimit .....	
	i. Dokumenti i auditimit.....	
<b>III.2.</b>	<b>Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....</b>	<b>24 – 92</b>
III.2/1.	Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA dhe buxhetit vjetor respektiv për periudhën 2019-2020.	25 – 29
III.2/2.	Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor; Niveli arkëtimit të gjobave të vendosura nga IMTV, apo organeve të tjera;	29 – 32
III.2/3.	Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të parashikuar opinionin mbi pasqyrat financiare për vitet 2019-2020.....	32 – 42
III.2/4	Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.....	42 – 80
III.2/4.	Auditim për zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit të kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve;	80 – 90
III.2/5.	Të ndryshme të dala gjatë auditimit.	90-92
<b>IV.</b>	<b>GJETJE DHE REKOMANDIMI.....</b>	<b>92 – 99</b>
<b>V.</b>	<b>ANEKSE.....</b>	<b>101-120</b>

### SHKURTIME

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues.
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues.
<b>GSM</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
<b>AB</b>	Auditi i Brendshëm
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
<b>FZHR</b>	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave.
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak.
<b>ISSAI</b>	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>ISA</b>	Standartet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>IFAC</b>	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit.
<b>NJA</b>	Njësi Administrative.
<b>SHA</b>	Shoqëri Anonimë.
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
<b>OE</b>	Operatori Ekonomik
<b>IVMT</b>	Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

KLSH në periudhën nga data 07.09.2021 deri me datë 08.10.2021 kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Bashkisë Fushë Arrëz për aktivitetin ekonomik dhe financiar të periudhës nga data 01.01.2019 deri më 31.12.2020, duke u përqendruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, planifikimin, hartimin dhe realizimin e buxheteve; zbatimin e strukturës organizative; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore; auditimin me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore; zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit të kontratave; mbajtjen e evidencës kontabël; zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe administrimin e pronës etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoj, analizoj dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit dhe Kodi i etikës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, të shpërblimeve të dëmit, mungesë së të ardhurave dhe të përdorimit jo me efektivitet të fondeve publike, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të Audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Fushë Arrëz për periudhën nga data 01.01.2019 deri më datë 31.12.2020, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë “*Opinion i pamodifikuar, me “theksim çështjeje”*”, për pasqyrat financiare dhe të përputhshmërisë, për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të këtij subjekti.

## I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Njësia Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1.	<p>Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e buxhetit, u konstatua se:</p> <p>-Për vitin 2019 buxheti është realizuar në masën 84% ose nga 471,242 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 394,636 mijë lekë, ndërsa për vitin 2020 është realizuar në masën 86% ose nga 385,527 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 332,879 mijë lekë.</p> <p>- Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara nuk është në nivel optimal, ku për vitin 2019 paraqitet në masën 86 %, ose nga vlera planifikuar prej 181,765 mijë lekë është realizuar vlera prej 155,562 mijë lekë dhe në vitin 2020 në masën 83 %, ose nga vlera planifikuar prej 81,623 mijë lekë është realizuar vlera prej 68,081 mijë lekë, pavarësisht faktit se niveli i investimeve nga njëra periudhë në tjetrën është në ulje për vlerën 100 milion lekë.</p>	E mesme	25-29	<p>Drejtoria e Financës dhe njësia e Programimit Buxhetor në bashkëpunim me Drejtorinë/ Sektorët e tjerë, gjatë hartimit dhe miratimit të buxhetit të planifikojë fonde për investime në raport me nivelin e të ardhurave të realizuara për vitin dhe grandeve të planifikuara nga qeveria, në raport me përqindjen e planifikuar.</p> <p>Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet kryesisht nga të ardhurat e veta.</p>
2.	<p>Për vitin 2020 detyrimet për fatura të pa likuiduara të bashkisë Fushë-Arrëz paraqiten në vlerën totale 3,410,092 lekë, sipas bilancit 2020, që i përkasin shpenzime për energji elektrike, fatura ujësjellësi, likuidim interneti, poste, ushqimet kopsht çerdhe dhe shpenzime investimesh në 4 raste. Për 4 rastet e fundit arsyeja ka qene se ministria e linjës që ka financuar projektet nuk ka buxhetuar realizimin e plote të objekteve të investimeve. Veprime në kundërshtim me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit, nëni 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, të ligjit nr. 88/2019 datë 18/12/2019 “Per buxhetin e vitit 2020”, të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të VKB nr. 37 date 20.12.2019 ” Për miratimin e buxhetit 2020”.</p>	E lartë	25-29	<p>-Të merren masa nga Bashkia Fushë Arrëz, që të zbatohen procedurat ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.</p>
3	<p>Sipas pasqyrës të rakorduar me thesarin, të ardhurat në total dhe në zëra analitike për 2 vitet paraqesin mosrealizime dhe grafikun e tyre është në rënie krahasuar me vitin 2019.</p> <p>- Programimi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifatat vendore dhe të ardhura tjera financiare, për vitin 2019, janë me mosrealizim në vlerën 6 milion lekë, ose 84%.</p>	E lartë	29-32	<p>Të merren masa nga Bashkia Fushë Arrëz, që të zbatohen procedurat ligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore dhe të ardhurat e tjera.</p>

Nëntja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Për vitin 2020, programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, dhe të ardhura të tjera financiare, është miratuar në vlerën rreth 26 milion mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën afro 22 milion lekë me mosrealizim në vlerën 10 milion lekë, ose 64%.			
4	<p><u>Fatura të pa likuiduara</u></p> <p>Për vitin 2020 detyrimet për fatura të pa likuiduara të bashkisë Fushë-Arrëz paraqiten në vlerën totale <b>3,410,092</b> lekë, sipas bilancit 2020, që i përkasin shpenzime për energji elektrike, fatura ujësjellësi, likuidim interneti, poste, ushqimet kopsht çerdhe dhe shpenzime investimesh në 4 raste. Për 4 rastet e fundit arsyeja ka qenë se ministria e linjës që ka financuar projektet nuk ka buxhetuar realizimin e plote të objekteve të investimeve. Veprime në kundërshtim me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit, nëni 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 "Detyrimet e prapambetura të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore", të ligjit nr. 88/2019 datë 18/12/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të VKB nr. 37 datë 20.12.2019 "Për miratimin e buxhetit 2020".</p>	E ulët	29-32	-Të merren masa nga Bashkia Fushë Arrëz, që të zbatohen procedurat ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.
5	<p><u>Vendime gjyqësore.</u></p> <p>Për vitet 2019-2020, bashkia Fushë-Arrëz ka likuiduar 4 vendime gjyqësore për largime nga puna, për vlerën 3,995,202 lekë me ndikim negativ në buxhetin e shtetit, për dublim page për të njëjtin vend pune ( pagese për inspektorin zëvendësues dhe për inspektorin e larguar, fituar me vendim gjykatës), ndërsa bashkia nuk ka nxjerrë përgjegjësinë dhe nuk ka marrë masa administrative ndaj personave fajtor, veprim në kundërshtim me pikën 62 e UMF 2 datë 6.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" ku thuhet se: "...Titullarët e njësisë të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative....", konkretisht: K.P. 634,202 leke, K.L. 1,756,320 leke, L.Gj. 671,552 leke dhe M. T. 933,128 leke (lëvizje me ulje në detyrë, kategori).</p>	E mesme	29-32	Të merren masa nga Bashkia Fushë Arrëz, që të zbatohen procedurat ligjore për nxjerrjen e përgjegjësive administrative.

Nëntja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
6.	<p>Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se:</p> <p>Bilanci duhej të mbahej në një versionet e programeve kompjuterike Alfa 5 (financa 5) në ndryshim nga ajo që është mbajtur në përgjigje të standarteve bashkohore.</p> <p>Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin, pasqyrën e performances financiare (shpenzime dhe të ardhura), pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e flukseve monetare (levizjet e fondeve), pasqyra e ndryshimeve në aktivet dhe fondet neto, pasqyra e investimeve dhe burimet e financimit, pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike dhe vlera neto) si dhe pasqyrat për fondet dhe numrin e punonjësve, formati nr.5 (pyetsori dhe shpjegimet) e tjera shoqëruese.</p> <p>Zërat e Aktiveve qëndrueshme janë zërtërhyer analitikisht me inventar kontabël dhe kuadrojnë. Investimet e përfunduara janë pasqyruar në bilanc dhe janë të inventarizuara në mënyrë analitike. Amortizimi vjetor pasqyrohet dhe është llogaritur sipas normave dhe tarifave ligjore, ndërsa amortizimi i mbartur është pasqyruar në bilanc dhe kundron me pasqyrën e amortizimit të bilancit. Llogaritë inventariale rezultoi se saldot e llogarive të pasqyruara në bilanc për aktivet e qëndrueshme dhe qarkulluese janë të njëjta me inventarin fizik.</p> <p>Pasqyra e shpenzimeve ka të pasqyruara shpenzimet sipas zërave analitik si shpenzime personeli, shpenzime për sigurimet shoqërore, shpenzime operative e tjera.</p> <p>Pasqyra nr.8 e bilancit “<i>Numri punonjësve dhe fondi i pagave</i>” është e plotësuar.</p> <p>Të ardhurat vendore dhe financimet tjera janë të pasqyruara në pasqyrën nr.2 të bilancit për 313,939 mijë lekë, e cila rekordon me evidencën e degës thesarit Pukë.</p> <p>Llogaritë e debi-kreditit janë të analizuar dhe të kuadruara me analizat përkatëse.</p> <p>Tepricat e llogarive të pasqyruara në bilancin e vitit 2019, janë mbartur si çelje për llogaritë e vitit 2020 pa gabime.</p> <p>Ditarët e kontabilitetit për vitin 2020 përkatësisht i thesarit, magazinës, pagave, të ndryshme, shpenzimeve janë mbajtur dhe azhurnuar në përputhje me Planin Unik Kontabël për institucionet buxhetore, dhe sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “<i>Për kontabilitetin</i>”, me VKM 248, datë 10.04.1998 “<i>Për ër përgatitjen dhe raportimin</i>”.</p>	E mesme	32-42	Të merren masa nga Bashkia Fushë Arrëz, Drejtoria e Financës, që të zbatohen procedurat ligjore për uljen dhe ndjekjen si dhe sistemimin e llogarisë “debitor të ndryshëm”.

Nëntja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësisive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” etj., të udhëzimit 8 date 09/03/2018 “Për procedurës e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe te UMF nr.14 datë 28.12.2006, të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik,” si dhe ligjit nr. 10296 date 10/07/2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.</p> <p>Vlerësimi i Raportimit Financiar, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi, konkretisht në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësisive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”; në udhëzimin e MF nr. 26, datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006, dhe udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, etj., për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë.</p> <p>Problem tek bilanci 2020 paraqet llogaria “debitor te ndryshëm” për vlerën 271,246,057 lekë, ndaj 23 subjekte fizike dhe juridike për detyrime prapambetura kontraktuale dhe rekomandime te KLSH, si dhe 97 persona për detyrime te ndryshme për taksa e tatime te pashlyera ndaj bashkisë te mbartura ne vite. Për sa i përket detyrimeve për subjektet debitorë, rezulton se bashkia Fushë Arrëz nuk ka dërguar nëpërmjet protokollit urdhrat e bllokimit ne adrese te bankave te nivelit te dyte.</p>			
7	<p>Nga Bashkia Fushë-Arrëz, për periudhën e audituar, me veprimet e bankës, u konstatuan shkelje dhe mangësi me efekte financiare për vlerën 9,600 leke, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ne 2 vitet 2019-2020 ka kryer padrejtësisht pagesën e taksës televizorit për 4 kontrata me</li> </ul>	E mesme	32-42	- Bashkia Fushë-Arrëz të ndjekë gjitha hapat ligjore për eliminimin dhe mos likuidimin e zërit “taksa e televizorit=100 leke/muaj” për 3 linjat e ndriçimit rrugor dhe 1 të tregut lire, të pasqyruar në faturat e OSHEE, pasi kjo vlerë është përfituar padrejtësisht.



Nëmbajtja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	OSHEE, duke shkaktuar një efekt negativ financiar 9,600 lekë,, - ne 3 raste për vitin 2019-2020 u konstatuan mangësi në praktikat dokumentare për likuidimin e shpenzimeve për mirëmbajtje rrugësh.			
8	Në lidhje me procedurat e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2019 rezulton se në 11 procedura nga 12 të zhvilluara gjithsej, pa përfshire blerjet me vlerë të vogël, nga ana e Njësisë së Prokurimit nuk janë argumentuar kriteret e vendosura në DST, në mospërputhje me nenin 59 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 „Për rregullat e prokurimit publik“, i ndryshuar dhe, për këtë, mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP.	E lartë	42-80	Kryetari i Bashkisë të marrë në analizë përbërjen e kapaciteteve që angazhon në njësinë e prokurimit dhe të saktësoj e përfshijë specialistë të fushës me qëllim argumentimin e përllogaritjes së fondit limit kryesisht për sa i përket investimeve në përputhje dhe me studimet e kryera në procesin e PBA për sa i përket projekt idesë në përcaktimin dhe alokimin e fondeve për çdo procedurë.
9	Në lidhje me procedurat e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2020 rezulton se në 8 procedura nga 9 të zhvilluara gjithsej, pa përfshire blerjet me vlerë të vogël, nga ana e Njësisë së Prokurimit nuk janë argumentuar kriteret e vendosura në DST, në mospërputhje me nenin 59 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 „Për rregullat e prokurimit publik“, i ndryshuar dhe, për këtë, mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP.	E lartë	42-80	Kryetari i Bashkisë të marrë në analizë përbërjen e kapaciteteve që angazhon në njësinë e prokurimit dhe të saktësoj e përfshijë specialistë të fushës me qëllim argumentimin e përllogaritjes së fondit limit kryesisht për sa i përket investimeve në përputhje dhe me studimet e kryera në procesin e PBA për sa i përket projekt idesë në përcaktimin dhe alokimin e fondeve për çdo procedurë.
10	Në 4 procedura të prokurimit publik nga 12 të zhvilluara gjithsej gjatë vitit 2019 rezulton se KVO padrejtësisht e ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE dhe OE të cilët nuk justifikojnë disponueshmërinë e kapaciteteve teknike e njerëzore pasi në të njëjtën periudhë të zbatimit të kontratës i kanë të angazhuara në vepra të tjera publike përfshi këtu dhe Bashkinë Fushë Arrëz. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, duke vepruar në kundërshtim me kërkesa e nenit 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe nenin 53, pika 3 “Shqyrtimi i ofertave”, të LPP, ku thuhet se “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, çka ngarkon me përgjegjësi KVO e cila ka shkaktuar përdorim të fondeve publike, me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të ulët, në vlerën 69,513,011 lekë, FL pa tvsh, respektivisht shuma prej 24,131,095 lekë në procedurën me objekt “Rikonstruksion i	E lartë	42-80	Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën <b>69,513,011 lekë</b> , duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Nëvetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	kanalit, fshati Iballe”; shuma prej 39,253,839 lekë në procedurën me objekt “Ndërtim i palestres dhe ambjenteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarsise”; shuma prej 3,120,977 lekë në procedurën me objekt “Sistemim , Asfaltim, Ndriçim i Rruges Auto L.Vjeter” dhe shuma prej 3,007,100 lekë në procedurën me objekt “Ndërtim bazamenteve të urave auto lagjia Koprat fshati Iballe dhe fshati Micoj”.			
11.	Nga auditimi i zbatimit të punimeve me objekt "Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarsise", Fushë Arrëz rezultoi se është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 2186 prot. datë 15.07.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Fushë Arrëz dhe Bashkimit të operatorëve ekonomik ose sipërmarrësit "P.G." shpk & "J." shpk. Vlera e kontratës është 47,104,606 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 8 muaj nga data e fillimit të punimeve. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi dhe në këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej <b>1,185,166 pa TVSH</b> , e përfituar nga sipërmarrësi, për punime të pakryera dhe të mbivendosura, ku disa zëra punimesh mund të ishin korrigjohen në periudhën e garancisë së punimeve.	E lartë	80-90	<p>- Nga Bashkia Fushë Arrëz të marren masa që të rishikohen volumet e punimeve civile, të shoqërohen me librezat masash të sakta, në mënyrë që pagesat të argumentohen mbi bazën e volumeve të sakta.</p> <p>- Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa, të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të paargumentuara në vlerën <b>1,185,166 lekë pa TVSH</b> nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare, për arkëtimin e vlerës.</p>
12.	Nga auditimi i zbatimit të punimeve me objekt "Rikonstruksioni i Kanalit Fshati Iballë, Nj. A. Iballë " rezultoi se është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 2378 prot. datë 31.07.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Fushë Arrëz dhe operatorit ekonomik ose sipërmarrësit "P.G." shpk. Vlera e kontratës është 28,957,314 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 8 muaj nga data e fillimit të punimeve. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi dhe në këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej <b>2,631,616 lekë pa TVSH</b> , e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara.	E lartë	80-90	<p>- Nga Bashkia Fushë Arrëz të marren masa që të rishikohen volumet e punimeve civile, të shoqërohen me profilet tërthorë e gjatësorë në librezat e masave, në mënyrë që pagesat të argumentohen mbi bazën e volumeve të sakta.</p> <p>- Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa, të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të paargumentuara në vlerën <b>2,631,616 pa TVSH</b> nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare, për arkëtimin e vlerës.</p>
13.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion me objekt " <b>Shërbime projektimi për projekte të financuara nga Bashkia Fushë-Arrëz</b> ", për vitin 2019", konstatohet se në bazë të procedurës së prokurimit zhvilluar më datë 04.12.2019 në bazë të urdhrin të	E lartë	80-90	Autoriteti Kontraktor, Bashkia Fushë Arrëz, të formojë një grup pune me specialistë të fushës për të verifikuar dorëzimin real të projekteve dhe përputhshmërinë me aktet e mbajtura me BOE sipërmarrës për të evidentuar arsyet e mos përfundimit në afat të kontratës, përgjegjësitë

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>prokurimit Nr. 366/2, Datë 15.11.2019 me FL në shumën 7,034,166 lekë pa tvsh, është shpallur fitues i tenderit BOE "A.S." sh.p.k, "HMK." sh.p.k, "T.H.C." sh.p.k, i përfaqësuar nga "A.S." sh.p.k dhe ka lidhur kontratën me AK me Nr. 4199, datë 26.12.2019 në shumën 6,401,091 lekë pa tvsh dhe në shumën 7,681,309 lekë me tvsh për për shërbime projektimi për 6 projekte. Afati i projektimit dhe dorëzimi i projekteve duhet të realizohet për 25 ditë, duke filluar në datën e lidhjes së kontratës 26.12.2019 dhe të dorëzohen tek AK në datën 25.01.2020.</p> <p>Nga auditimi rezulton se projektet janë marrë në dorëzim tej afatit të përcaktuar në kontratë. Në bazë të procesverbalit të marrjes në dorëzim të datës 04.08.2020 nga Komisioni i pritjes së mallit për vitin 2020 projektet janë marrë në dorëzim në datën 04.08.2020 tej afatit të përcaktuar në kontratë të cilat duhej të shoqëroheshin me penalitet për mos dorëzim në afat të projekteve në shumën <b>4,455,096 lekë</b> e cila nuk është adresuar nga Autoriteti Kontraktor.</p>			<p>respektive dhe marrjen e masave për zbatimin e kontratës për penalitet në shumën <b>4,455,096 lekë</b> ndaj sipërmarrësit të realizimit të projekteve.</p>

## I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

### Opinioni mbi pasqyrat financiare

Në kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Fushë Arrëz, për vitin ushtrimor 2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

### **Opinion i pamodifikuar, me "theksim çështjeje"<sup>1</sup>:**

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705<sup>2</sup>, dhe ISSAI 1200<sup>3</sup>, pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat

<sup>1</sup> *Opinion i pamodifikuar me theksim çështjeje.* Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënie të kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si "theksimi i çështjes" përfshihen në një paragraf të veçantë nga ai i opinionit.

<sup>2</sup> *Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.*

<sup>3</sup> *Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi*

përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”.

### **Baza për opinionin e pamodifikuar, me theksim çështjeje:**

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Fushë Arrëz, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700). Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar të auditimit.

### **Theksimi i çështjeve:**

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Bashkia Fushë Arrëz, sa vijon:

*-Për sistemin dhe ndjekje të llogarisë “debitor te ndryshëm” për vlerën 271,246,057 lekë.*

*-Nga Bashkia Fushë-Arrëz, për periudhën e audituar, me veprimet e bankës, u konstatuan shkelje dhe mangësi me efekte financiare për vlerën 9,600 leke, konkretisht:*

*- ne 2 vitet 2019-2020 ka kryer padrejtësisht pagesën e taksës televizorit për 4 kontrata me OSHEE, duke shkaktuar një efekt negativ financiar 9,600 lekë,*

*- ne 3 raste për vitin 2019-2020 u konstatuan mangësi në praktikat dokumentare për likuidimin e shpenzimeve për mirëmbajtje rrugësh,*

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Fushë Arrëz:**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Fushë Arrëz, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Fushë Arrëz janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme<sup>7</sup>, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

<sup>7</sup> ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë për publikun e gjerë.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 868/1 datë 01.09.2021 “Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Fushë Arrëz”, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 07.09.2021 – 08.10.2021, në subjektin Bashkia Fushë Arrëz për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2019 – 31.12.2020, u krye auditimi “Auditim Financiar dhe Përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **A.Th., Përgjegjës Grupi**
2. **B.B., Auditues**
3. **A.K., Auditues**

**c- Objekti i auditimit:** Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2019 dhe 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

- Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbime e investimeve.

- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

- Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

**Qëllimi i auditimit** të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Gjithashtu, pjesë e raportit të auditimit do të jetë, opinionit mbi përputhshmërinë, nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (kriteret e paracaktuara).

**d- Identifikimi i çështjes:** Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje,

duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 "Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi", duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Fushë Arrëz.

**e- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:** Administratori i Përgjithshëm, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) z. F.T., Kryetar i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ) z. D.L., janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Fushë Arrëz, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht neni 34, pika 6<sup>8</sup>, neni 65, pika 1<sup>9</sup> dhe neni 91, pika 1.3<sup>10</sup>.

**f- Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:** Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Fushë Arrëz dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me

---

<sup>8</sup> "Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore"

<sup>9</sup> "Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori".

<sup>10</sup> "Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përbushjen e funksioneve të tyre;
- b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
- c) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit".

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

**Parimet e auditimit financiar:** Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- *Etika dhe pavarësia;*
- *Kontrolli i cilësisë*
- *Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre*
- *Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.*

**Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:**

- *Përkatësia:* Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Saktësia:* Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
- *Periudha:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël
- *Klasifikimi:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura
- *Ligjshmëria dhe rregullsia:* Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

**Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

- *Ekzistenca:* asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë
- *Të drejtat dhe detyrimet:* Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit
- *Plotësia:* Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Vlerësimi dhe alokimi:* Aktivët, pasivët dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

**Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

- *Transaksionet,* të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
- *Klasifikimi dhe kuptueshmëria:* Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.
- *Saktësia dhe vlerësimi:* Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

**g- Kriteret e vlerësimit:** Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

▪ **Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:**

Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006, aktualisht i shfuqizuar; ligji nr. 99/2018, datë 31.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, Ligji nr. 88/18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020” dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr.

48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.03.2015; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117- Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.

▪ **Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit Pasqyrave Financiare:**

Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”, aktualisht i shfuqizuar; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standartet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

▪ **Në fushën e prokurimeve publike:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzimi i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

▪ **Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:**

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

▪ **Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:**

Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për Nënpunësin Civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat



për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

**h- Standardet e auditimit:** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

**i- Metodatat e auditimit:** Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin<sup>11</sup>.*

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:*

- **Kontrolli aritmetik.** Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- **Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.** Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara

---

<sup>11</sup> ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërive ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normale”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
- *Intervista*
- *Raporte dhe Informacione*
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK*

**j- Dokumentimi i auditimit:** Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja<sup>12</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

---

<sup>12</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.**

#### **III/1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:**

**Bashkia Fushë Arrëz** i përket Qarkut Shkodër, kufizohet në veri me Bashkinë Tropojë, në perëndim me bashkitë Vau i Dejës dhe jug-perëndim me bashkitë Pukë dhe Mirditë. Në lindje kufizohet me Bashkinë Kukës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Fushë-Arrësit. Përbëhet nga 5 Njësi Administrative: Nj.A. Fushë Arrës mbulon fshatrat Micaj, Lumëardhe; Nj. A. Fierzë mbulon fshatrat Fierzë, Porav, Bugjon, Kokëdodë, Arst, Miliska, Mëzi dhe Agrip Guri; Nj. A. Blerim mbulon fshatrat Flet, Xeth, Kulumri, Trun, Blerim, Dardhë dhe Qebik; Nj. A. Qafë Mali mbulon fshatrat Qafë Mali, Armiraj, Srriqe, Mollkuqe, Lajthizë, Lumbardhë, Tuc, Kryezi dhe Orosh; Nj. A. Iballë mbulon fshatrat Berishë e Sipërme, Shopel dhe Mërtur. Mbulon një territor afërsisht 540 km<sup>2</sup> dhe me popullsi sipas regjistrimit të gjendjes civile 11,651 banorë.

Këshilli Bashkisë Fushë Arrëz përbëhet nga 15 anëtarë dhe bashkia drejtohet nga Kryetari i Bashkisë Fran Tuci.

#### **Prioritetet e Bashkisë për vitet 2019 – 2020.**

- Përmirësimi i strukturës së shërbimeve publike.
- Përmirësimi i strukturës mbështetëse të arsimit parashkollor dhe të mesëm.
- Përmirësimi i strukturës së shërbimeve të rrugëve rurale.
- Përmirësimi i strukturës së administrimit pyjor
- Përmirësimi i strukturës së mbrojtjes nga zjarri.
- Përmirësimi i menaxhimit të njësive shpenzuese në varësi të bashkisë.
- Ruajtjen e vazhdimësisë së kryerjes së investimeve të planifikuara.
- Përmirësimin e të ardhurave të veta të bashkisë nëpërmjet planifikimit analitik të tyre.
- Mbajtjes nën kontroll të shpenzimeve për çdo njësi shpenzuese.
- Rritjes së kontrollit mbi territorin.
- Politikat në fushën e investimeve synojnë kryerjen e investimeve në funksion të rritjes ekonomike, rritje e cilësisë së shërbimeve dhe zgjerimit të tyre të cilat do të mundësohen nëpërmjet:
- Financimit të investimeve kapitale
- Përmirësimin të shërbimit të gjelbërimit dhe ndriçimit të qytetit
- Paraqitjes së projekteve për përmirësimin e infrastrukturës së qytetit dhe aplikimin tek FZHR.

- **Fushëveprimi:** Përfshin vlerësimin e përputhshmërisë së Bashkisë Fushë Arrëz, në fushën e prokurimeve publike, për periudhën objekt auditimi si dhe vlerësimin nëse pasqyrat financiare të njësisë për vitet 2019 - 2020, nëse janë hartuar sipas standardeve të raportimit financiar.

### **III/2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDIMIT.**

#### **III/2.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA dhe buxhetit vjetor respektiv për periudhën 2019-2020.**

##### Struktura dhe organika.

Bashkia Fushë-Arrëz për vitin 2019 dhe 2020 funksionon me një strukturë dhe organike prej mesatarisht 218 punonjës, e cila është e organizuar në 4 njësi administrative dhe bashkia qender, përkatësisht:

- Sektori i Auditit brendshëm,
- Sektori i burimeve njerëzore,
- Sektori juridik dhe i prokurimeve,
- Policia Bashkiake,
- Sektori i Financës,
- Sektori i Ceshtjeve Sociale,
- Sektori i Tatim Taksave,
- Drejtoria e Sherbimeve Publike,
- Arsimi baze dhe i mesem,
- Administrimi i pyjeve dhe kullotave,
- Mbrojtja nga zjarri,
- Sektori i rrugeve rurale,
- Ujitja dhe kullimi,
- Njësi administrative Iball,
- Njësi administrative Blerim,
- Njësi administrative Fierze,
- Njësi administrative Qafë Mali,

##### Buxheti.

Bashkia Fushë-Arrëz për vitin 2019-2020 ka hartuar dhe miratuar buxhetin e saj, në zbatim të kërkesave:

- të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,
- të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin sistemit buxhetor në RSH”, ndryshuar,
- të ligjit nr. 88/2019 datë 18/12/2019 “Per buxhetin e vitit 2020”,
- të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,
- të VKB nr. 37 date 20.12.2019 ” Për miratimin e buxhetit 2020”, konfirmuar nga prefektura Shkodër, sipas shkresës nr. 46/1 date 15.01.2020.
- të VKB nr. 148 date 24.12.2018 ” Për miratimin e buxhetit 2019”,
- te shkresës MF nr. 20458 date 11.11.2019,
- te shkresës MF nr. 19369 date 30.10.2018,

Detajimi i shpenzimeve dhe ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore.

Programet buxhetore dhe detajimet e tyre janë miratuar me vendimet përkatëse dhe konkretisht me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 148, datë 24.12.2018 është miratuar buxheti i vitit 2019 i cili është konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Shkodër me shkresën nr. 20/1, datë 16.1.2019, ky

vendim është ndryshuar me VKB nr. 60 datë 5.6.2019 “Për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave të trashëguara nga viti 2018” i cili është konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Shkodër me shkresën nr. 703/1, datë 24.6.2019 ndërsa, me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 37, datë 20.12.2019 është miratuar buxheti i vitit 2020 i cili është konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Shkodër me shkresën nr. 46/1, datë 15.1.2020, ky vendim është ndryshuar me VKB nr. 27 datë 26.6.2020 “Për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave të trashëguara nga viti 2019” i cili është konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Shkodër me shkresën nr. 520/1, datë 15.7.2020. Siç vihet re ndryshimet e buxhetit janë miratuar në instancat përkatëse duke kaluar në të gjitha hallkat sipas legjislacionit në fuqi.

Plani buxhetor është detajuar e ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor.

Janë kryer akt rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.

Për vitin 2019 dhe 2020 planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve sipas artikujve, paraqitet sipas pasqyrës së mëposhtme:

*000/lekë*

Nr.	Emërtimi	2019			2020		
		PLAN	FAKT	Realiz %	PLAN	FAKT	Realiz %
1	600 Paga	127,168	108,810	85.56	125,588	109,331	87.06
2	601 Sig.shoq.	22,643	17,155	75.76	20,642	18,241	88.37
3	602+ F. Rez.	37,643	23,112	61.40	49,653	29,782	59.98
5	604	323	100	30.96	100		0.00
6	606 Nd.ekon.inval	90,900	89,494	98.45	100,144	99,687	99.54
7	230 Studime Projektme	10,800	403	3.73	7,777	7,757	99.74
8	231. Investime	181,765	155,562	85.58	81,623	68,081	83.41
<b>TOTALI:</b>		<b>471,242</b>	<b>394,636</b>	<b>83.74</b>	<b>385,527</b>	<b>332,879</b>	<b>86.34</b>

Nga auditimi dhe referuar pasqyrës së shpenzimeve 2019 dhe 2020 të rakorduar me thesarin, u konstatua se nuk ka tejkalim shpenzimesh sipas artikujve, pasi këto kanë qenë edhe nën kontrollin e Degës Thesarit Pukë.

Referuar situacioneve të shpenzimeve vjetore sipas artikujve për 2 vitet, rezulton se:

-Shpenzimet për paga me shpenzimet operative për 2 vitet janë në raport të drejtë midis tyre, pasi pesha e shpenzimeve operative është 21 dhe 27 % ndaj shpenzimeve për paga, çka tregon efikasitet, ekonomicitet dhe efektivitet të shpenzimeve sipas artikujve.

-Shpenzimet për investime (llog.231) paraqesin peshën më të madhe ndaj shpenzimeve në total,

Për vitin 2019, shpenzimet operative paraqiten sipas pasqyrës së vijon:

*Në Leke*

Shpenzime operative	Plan	Fakt	Realizim ne %
kancelari	1,726,000	1,137,241	65.89
pastrim	455,000	285,624	62.77

uniforme	251,000		0.00
ushqime	1,234,000	1,171,950	94.97
libra-publikime	250,000		0.00
elektricitet	2,705,000	2,353,933	87.02
Uje	562,000	313,842	55.84
telefon	1,181,000	579,901	49.10
poste-korrier	254,000	136,290	53.66
lende djegese	2,091,000	1,944,000	92.97
Sherbime publike	250,000		0.00
Karburant	7,903,000	5,987,000	75.76
Pjese kembimi	1,638,000		0.00
prim sigurimi	1,107,000		0.00
Djeta	2,541,000	2,419,500	95.22
mm.ndertese	440,000		0.00
Mm rrugeshe dhe kanale vaditese	2,331,000	1,415,561	60.73
V.Gjyqesore	9,767,000	162,000	1.66
Keshilltare	3,985,000	3,645,534	91.48
te tjera	1,211,000	1,307,124	107.94
Shperblime per fatkeqesi dhe pension	252,000	252,500	100.20
<b>Totali:</b>	<b>42,134,000</b>	<b>23,112,000</b>	<b>54.85</b>

Për vitin 2020, shpenzimet operative paraqiten sipas pasqyrës sa vijon:

*Në Leke*

<b>Shpenzime operative</b>	<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	<b>Realizim ne %</b>
Kancelari	1,645,000	1,233,103	74.96
Pastrim	650,000	648,240	99.73
Uniforme	215,000		0.00
Ushqime	3,000,000	2,911,014	97.03
libra-publikime	150,000	50,000	33.33
Elektricitet	3,558,000	2,473,879	69.53
Uje	1,135,000	881,654	77.68
Telefon	1,141,000	300,225	26.31
poste-korrier	254,000	105,978	41.72
lende djegese	2,122,000		0.00
Sherbime publike	250,000	216,000	86.40
Karburant	6,068,000	6,068,000	100.00
Pjese kembimi	2,217,000	1,319,220	59.50
prim sigurimi	1,752,000	500,000	28.54
Djeta	2,079,000	1,735,500	83.48
mm.ndertese	763,000	368,016	48.23
Mm rrugeshe dhe kanale vaditese	4,189,000	479,400	11.44
mm.mjete trans	849,000		0.00
V.Gjyqesore	14,647,000	2,966,120	20.25
Argetime	95,240	95,240	100.00
Honorare	89,250	89,250	100.00
Keshilltare	3,387,000	3,723,746	109.94
te tjera	1,823,000	1,308,830	71.80
<b>604</b>			
Djegje banese	1,443,868	1,443,868	100.00
Te tjera	3,391	3,391	100.00

<b>606</b>			
Shperblim lindje	345,000	345,000	100.00
Shperblim dalje ne pension	515,383	515,383	100.00
<b>Totali:</b>	<b>54,386,132</b>	<b>29,781,057</b>	<b>54.76</b>

Shpenzimet operative ne total nuk paraqesin tejkalime për 2 vitet 2019-2020.

Të ardhurat

Pasqyra e te ardhurave vendore te bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2019 dhe 2020, sa vijon:

000/leke

Nr.	Emertimi	Plan 2019	Fakt 2019	Plan 2020	Fakt 2020
1	T.TH.F	-	70	-	213
2	Takse bujqesore	620	6	626	51
3	Takse ndertese	8,313	3,481	8,742	2,888
4	Takse trualli	412	373	416	388
5	Makinat e perdorura	1,300	1,659	832	1,743
6	Takse hapësire publike	210	96	250	401
7	Ndikim ne infrastruktur	600	1,034	187	95
8	Takse ndriçimi	380	150	368	308
9	Tarife Shfrytëzimi	3,100	2,714	4,149	1,061
10	Taksa Vendore te përkohshme	-	10	-	-
11	Takse tregu	-	-	-	7
12	Takse Leje ndërtimi	-	479	-	1,494
13	Qera	6,940	7,109	7,079	2,648
14	Qira nga Ndërtesat	-	325	-	-
15	Tarife Leje Transporti	400	807	350	773
16	Takse Pastrimi	2,500	1,394	1,826	1,504
17	Tarife shkres perc	-	-	-	1
18	Te ardhura Kopshte	410	292	400	159
19	Te ardhura Qerdhe	210	177	200	69
20	Takse Parkingu	206	-	208	8
21	Te ardhura nga MNZSH	100	20	100	60
22	Takse Jo tatimore	-	-	-	37
23	Grande	-	128	-	1,627
24	Grande	-	260	-	-
25	Sponsorizime	-	1,169	-	455
	<b>TOTALI</b>	<b>25,701</b>	<b>21,753</b>	<b>25,733</b>	<b>15,990</b>

Sipas pasqyrës te rakorduar me thesarin, të ardhurat në total dhe në zëra analitike për 2 vitet paraqesin mosrealizime dhe grafiku i tyre është ne rënie krahasuar me vitin 2019, çka bën përgjegjës sektorin e taksave vendore zj. A.D., me detyrë Specialiste në Sektorin e Të Ardhurave.

*Në KLSH është paraqitur observacioni mbi projektraportin me nr. 868/3, datë 09.12.2021 nga Bashkia Fushë Arrëz.*

*Pretendimi i subjektit: Sipas pasqyrës te rakorduar me thesarin, të ardhurat në total dhe në zëra analitike për 2 vitet paraqesin mosrealizime dhe grafiku i tyre është ne rënie krahasuar me vitin 2019, çka bën përgjegjës sektorin e taksave vendore z. V.P. dhe zj. A.D. Z. V.P. nuk ka qenë në detyrë në këtë periudhë.*

*Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni merret në konsideratë pasi është shoqëruar me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 151, datë 25.05.2021 për ndryshim pozicioni.*

<b>Titulli Gjetjes</b>	<i>-Performancë e ulët në realizimin e të ardhurave.</i>
<b>Situata:</b>	<i>- Programimi i të ardhurave nga tatimet, taksat dhe tarifave vendore dhe të ardhura të tjera financiare, për vitin 2019, janë me mosrealizim në vlerën 6 milion lekë, ose janë realizuar në masën 84% të planit. Për vitin 2020, programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, dhe të ardhura të tjera financiare, është miratuar në vlerën rreth 26 milion lekë, realizuar në fakt në vlerën afro 22 milion lekë me mosrealizim në vlerën 4 milion lekë, ose realizuar në masën 64% të planit.</i>
<b>Kriteri</b>	<i>-Aktet ligjore të sistemit të taksave dhe tarifave vendore, paketa fiskale miratuar me VKB.</i>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	<i>- Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve</i>
<b>Shkaku</b>	<i>-Moszbatim i plote ose i pjesshëm i akteve të miratuara nga KB për Taksat dhe Tarifave vendore dhe të ardhurave të tjera financiare.</i>
<b>Rëndësia:</b>	<i>-E mesme.</i>
<b>Rekomandimi</b>	<i>Të merren masa nga Bashkia Fushë Arrëz, që të zbatohen procedurat ligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore dhe të ardhurat tjera.</i>

#### Fatura të pa likuiduara

Për vitin 2020 detyrimet për fatura të pa likuiduara të bashkisë Fushë-Arrëz paraqiten në vlerën totale 3,410,092 lekë, sipas bilancit 2020, që i përkasin shpenzimeve për energji elektrike, fatura ujësjellësi, likuidim interneti, poste, ushqimet kopsht çerdhe dhe shpenzime investimesh në 4 raste. Për 4 rastet e fundit arsyeja ka qenë se ministria e linjës që ka financuar projektet nuk ka buxhetuar realizimin e plote të objekteve të investimeve veprime që nuk përputhen me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit, neni 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", të ligjit nr. 88/2019 datë 18/12/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të VKB nr. 37 datë 20.12.2019 "Për miratimin e buxhetit 2020".

<b>Titulli Gjetjes</b>	<i>-Faturat e pa likuiduara.</i>
<b>Situata:</b>	<i>-Bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare, në datën 31.12.2020 Bashkia Fushë Arrëz ka ulur detyrimin ndaj të tretëve deri në vlerën <b>3,410,092 lekë</b>, ose 3-fish më pak se vlera 10,849,996 lekë në datën 31.12.2018</i>
<b>Kriteri</b>	<i>-Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018 "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91-Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, të ligjit nr. 88/2019 datë</i>



	<i>18/12/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", të VKB nr. 37 date 20.12.2019 "</i> <i>Për miratimin e buxhetit 2020".</i>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	<i>-Diferenca e lehte midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, në total treguesit e buxhetit për këtë zë për vitin 2020 janë realizuar respektivisht duke ulur nivelin e faturave të pa likuiduara në masën 70% nga 30% në vitin 2018.</i>
<b>Shkaku</b>	<i>- Mos zbatimi i kërkesave ligjore.</i>
<b>Rëndësia:</b>	<i>-E ulët.</i>
<b>Rekomandimi</b>	<i>-Të merren masa nga Bashkia Fushë Arrëz, që të zbatohen procedurat ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.</i>

#### Vendime gjyqësore.

Për vitet 2019-2020, bashkia Fushë-Arrëz ka likuiduar 4 vendime gjyqësore për largime nga puna, për vlerën 3,995,202 lekë me ndikim negativ në buxhetin e shtetit, për dublim page për të njëjtin vend pune ( *pagese për inspektorin zëvendësues dhe për inspektorin e larguar, fituar me vendim gjykatës*), ndërsa bashkia nuk ka nxjerrë përgjegjësinë dhe nuk ka marrë masa administrative ndaj personave fajtor, veprim që nuk përputhet me kërkesat e pikës 62 e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" ku thuhet se: "...Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësisë administrative...", konkretisht: K.P. 634,202 leke, K.Ll. 1,756,320 leke, L.Gj. 671,552 leke dhe M.T. 933,128 leke (*lëvizje me ulje në detyre, kategori*).

<b>Titulli Gjetjes</b>	<i>-Pagesa nga buxheti për Vendime Gjykatë.</i>
<b>Situata:</b>	<i>-Nuk janë nxjerrë përgjegjësitë dhe nuk janë marrë masa administrative ndaj personave fajtor, për pagesat e dubluara, si rezultat i largimit nga puna të 4 ish-punonjësve të bashkisë Fushë-Arrëz dhe të fituara në gjykatë si akte të paligjshme, sipas vendimeve të gjykatës në vlerën <b>3,995,202 lekë</b> me ndikim negativ në buxhetin e shtetit, për dublim page për të njëjtin vend pune .</i>
<b>Kriteri</b>	<i>-Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, -Udhëzimi nr. 2, datë 06.02. 2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". pikës 62.</i>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	<i>-Efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore, nga zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit.</i>
<b>Shkaku</b>	<i>- Mos zbatimi i kërkesave ligjore.</i>
<b>Rëndësia:</b>	<i>-E mesme.</i>
<b>Rekomandimi</b>	<i>Të merren masa nga Bashkia Fushë Arrëz, që të zbatohen procedurat ligjore për nxjerrjen e përgjegjësisë administrative.</i>

#### **B. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të parashikuar opinion mbi pasqyrat financiare për vitet 2019-2020.**

##### Bilanci i Vitit 2020

Bilanci i vitit 2020 i bashkisë Fushe Arrez është hartuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Finances D.L. dhe është mbyllur brenda afatit ligjor date 10.03.2021, sipas shkresës nr. 599, datë 10.03.2021 në adresë të Degës së Thesarit Pukë.

Bilanci duhej të mbahej në një nga versionet e programeve kompjuterike Alfa 5 (ose financa 5) në ndryshim nga ajo që është mbajtur në përgjigje të standarteve bashkohore.

Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin, pasqyrën e performances financiare (shpenzime dhe të ardhura), pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e flukseve monetare (levizjet e fondeve), pasqyra e ndryshimeve në aktivet dhe fondet neto, pasqyra e investimeve dhe burimet e financimit, pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike dhe vlera neto) si dhe pasqyrat për fondet dhe numrin e punonjesve, formati nr.5 (pyetsori dhe shpjegimet) e tjera shoqëruese.

Zërat e Aktiveve qëndrueshme janë zberthyer analitikisht me inventar kontabël dhe kuadrojnë. Investimet e përfunduara janë pasqyruar në bilanc dhe janë të inventarizuara në mënyrë analitike. Amortizimi vjetor pasqyrohet dhe është llogaritur sipas normave dhe tarifave ligjore, ndërsa amortizimi i mbartur është pasqyruar në bilanc dhe kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit. Në llogaritë inventariale rezultoi se saldot e llogarive të pasqyruara në bilanc për aktivet e qëndrueshme dhe qarkulluese janë të njëjta me inventarin fizik.

Pasqyra e shpenzimeve ka të pasqyruara shpenzimet sipas zërave analitik si shpenzime personeli, shpenzime për sigurimet shoqërore, shpenzime operative e tjera.

Pasqyra nr.8 e bilancit “*Numri punonjësve dhe fondi i pagave*” është e plotësuar.

Të ardhurat vendore dhe financimet tjera janë të pasqyruara në pasqyrën nr. 2 të bilancit për 313, 939 mijë lekë, e cila rekordon me evidencën e Degës së Thesarit, Pukë.

Llogaritë e debi-kreditit janë të analizuar dhe të kuadruara me analizat përkatëse.

Tepëricat e llogarive të pasqyruara në bilancin e vitit 2019, *Aneksi nr. 1* bashkëlidhur raportit, janë mbartur si çelje për llogaritë e vitit 2020 pa gabime.

Ditarët e kontabilitetit për vitin 2020 përkatësisht i thesarit, magazinës, pagave, të ndryshme, dhe i shpenzimeve janë mbajtur dhe azhurnuar në përputhje me Planin Unik Kontabël për institucionet buxhetore, dhe sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin*” i shfuqizuar, me VKM 248, datë 10.04.1998 “*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësite të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj*” etj., të Udhëzimit nr. 8, datë 09/03/2018 të MF “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” dhe të UMF nr.14, datë 28.12.2006, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik,*” si dhe ligjit nr. 10296, datë 10/07/2010 “*Per menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar.

Vlerësimi i Raportimit Financiar është mbështetur në kuadrin rregullator në fuqi, konkretisht në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 “*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësite të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj*”; në udhëzimin e MF nr. 26, datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006, dhe udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësite të Qeverisjes së Përgjithshme*”, etj., për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë.

**Problem tek bilanci 2020 paraqet llogaria “debitor të ndryshëm” për vlerën 271,246,057 lekë,** ndaj 23 subjekteve fizike dhe juridike për detyrime prapambetura kontraktuale dhe rekomandime të KLSH, si dhe 97 persona për detyrime të ndryshme për taksa e tatime të pashlyera ndaj bashkisë të mbartura në vite. Për sa i përket detyrimeve për subjektet debitorë, rezulton se bashkia Fushë

Arrëz nuk ka dërguar nëpërmjet protokollit urdhrat e bllokimit në adrese të bankave të nivelit të dytë.

<b>Titulli Gjetjes:</b>	<i>-Mos sistemim dhe ndjekje të llogarisë “debitor të ndryshëm” për vlerën 271,246,057 lekë</i>
<b>Situata:</b>	<i>-Vlera e llogarisë “debitor të ndryshëm nuk është sistemuar dhe ndjekur për efekt të uljes së nivelit saj dhe për eliminimin e debitorëve të prapambetur.</i>
<b>Kriteri:</b>	<i>-Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, UMF nr. 14 datë 28.12.2006 i ndryshuar me nr. 26, datë 27.12.2007 Kap. II, pika 3</i>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<i>-Mos realizim ardhurash, si rezultat i ndjekjes pjesëshe të debitorëve prapambetur.</i>
<b>Shkaku:</b>	<i>-Arsye objektive dhe subjektive si dhe moszbatim i kërkesave ligjore.</i>
<b>Rëndësia:</b>	<i>-E mesme.</i>
<b>Rekomandimi:</b>	<i>-Të merren masa nga Bashkia Fushë Arrëz, Drejtoria e Financës, që të zbatohen procedurat ligjore për uljen dhe ndjekjen si dhe sistemimin e llogarisë “debitor të ndryshëm”.</i>

#### Banka 2019-2020.

Nga auditimi me zgjedhje të dokumentacionit të bankës në Bashkinë Fushë-Arrëz për vitin 2019 dhe 2020, rezultoi se:

Veprimet e bankës janë kontabilizuar, azhurnuar periodikisht në ditarin përkatës.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Likuidimet në përgjithësi janë të shoqëruara me dokumentacion justifikues.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Llogaritë janë në pozicionin e duhur në përputhje me kërkesat ligjore, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”, i shfuqizuar dhe me Udhëzimet e Ministrit të Financave.

Nga auditimi i veprimeve me bankën për vitin 2019 dhe 2020, u konstatuan edhe disa mangësi dhe shkelje ligjore me efekte financiare, konkretisht:

#### Shpenzime pa baze ligjore.

**1.** Bashkia Fushë-Arrëz ka kryer likuidime sipas urdhër shpenzimeve 2019 dhe 2020, për shpenzime për furnizimin me energji elektrike në bazë të faturave tatimore të lëshuara nga furnizuesi.

Furnitori OSHEE në faturimet e tij për harxhimin e energjisë për vitin 2019 dhe 2020 **ka shtuar si zë shpenzimi taksën e televizorit** edhe për **3 linjat e ndriçimit rrugor dhe 1 të tregut libre**, të administruara nga Bashkia Fushë-Arrëz .

Kështu, Bashkia ka vazhduar pagesën e taksës televizorit për këto 4 kontrata, por kjo taksë rëndon padrejtësisht shpenzimet e institucionit, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 9, pika 4, neni 12 pika 3, duke shkaktuar një **efekt negativ financiar në shpenzime në shumën 9,600 lekë** (12 muaj x 100 leke/muaji = 1200 leke x 4 linjat = 4800 leke/vit x 2 vitet = 9,600 lekë).

Pavarësisht vlerës së ulët, nga Bashkia për këtë mbi faturim nuk ka korrespondencë zyrtare dhe nuk është ndjekur në rrugë administrative dhe gjyqësore ky problem, duke mos i dhënë zgjidhje, në kundërshtim me ligjin 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë” neni 420 dhe 693 dhe me kontratat e lidhura me OSHEE, duke **ngarkuar me përgjegjësi Sektorin Juridik konkretisht z. L.Nd., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik; zj. S.M., me detyrë Specialiste e Sektorit Juridik dhe, dhe të Financës, z. D.L., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik.**

**TVSH e përfituar 2 herë.**

2. Sipas urdhër shpenzimit nr. 402 datë 24.12.2019 është likuiduar vlera 8,534,863 lekë për subjektin “**P.G.shpk**”, bazuar në faturën nr. 333 datë 24.12.2019 dhe situacionin të punimeve nr. 3, datë 02.08.2019 deri 23.12.2019 për objektin “**Ndërtim palestres dhe ambienteve sportive shkolla Fushë-Arrëz**”, rezultoi se:

Vlera **39,760 lekë** dëm ekonomik (198,800 x 20%), pasi subjekti zërat “**Pajisjet e palestrës**” i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit.

Për rrjedhojë tvsh është përfituar 2 herë, në moszbatim të kërkesave të udhëzimit nr.2 datë 8.5.2003, çka përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Sipas situacionit, paisjet e palestres, paraqiten në mënyrë analitike, sa vijon:

-FV Rezervuari xingate 5000 litër	copë 1 x 110,000 = 110,000 lekë,
-FV Galexhant mekanik 1 ½	copë 1 x 4,000 = 4,000 lekë,
-FV Sariçineske bronxi 0 1/2	copë 4 x 3,100 = 12,400 lekë,
-FV Sariçineske bronxi sferike 0 2	copë 4 x 3,100 = 12,400 lekë,
-Pusete shkarkimi	copë 2 x 30,000 = 60,000 lekë,
shuma	= 198,800 lekë.

3. Po kështu është vepruar sipas urdhër shpenzimit nr. 232, datë 26.08.2020 dhe situacionit përfundimtar, ku rezulton se:

Subjekti “**P.G. shpk**” 4 zërat “**Pajisjet hidrosanitare**” i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit. Për rrjedhojë tvsh është përfituar 2 herë, në moszbatim të kërkesave të udhëzimit nr. 2 datë 8.5.2003, çka përbën dëm ekonomik për vlerën **27,904 leke** per buxhetin e shtetit. Sipas situacionit, pajisjet hidrosanitare, paraqiten në mënyrë analitike, sa vijon:

-FV ËC allafranga importi	copë 2 x 14,562 = 29,124 lekë,
-FV Lavaman porcelan importi me mishelator	copë 2 x 13,613 = 27,226 lekë,
-FV Dush porcelani importi dhe mishelator	copë 4 x 20,168 = 80,672 lekë,
-FV Bolier importi V=80 liter porcelan	copë 2 x 15,200 = 30,400 lekë,

**Ngarkohet me përgjegjësi specialisti i fushës që ka firmosur situacionin ing. T.P., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikim-Territorit, si dhe supervizori T.S.**

4. Sipas urdhër shpenzimit nr. 219 datë 18.07.2019 është likuiduar vlera 14,991,851 lekë për subjektin fitues “V.Nd.shpk”, bazuar në faturën nr. 84 datë 05.07.2019 dhe situacionin të punimeve nr. 3 (15,780,896 leke) për objektin “**Rikonstruksion i shkollës mesme 70-vjetori Fushë-Arrëz**”, rezultoi se:

Subjekti pjesërisht zërat “**Pajisjet e ngrohjes**” i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit. Për rrjedhojë tvsh është përfituar 2 herë, në moszbatim të kërkesave të udhëzimit nr. 2 datë 8.5.2003, çka përbën dëm ekonomik për vlerën 467,032 leke ( $987,032 - 520,000$ ), sipas përlllogaritjeve ( *makineri dhe pajisje hidrosanitare, ngrohje, mbrojtje nga zjarri gjithsej*= $4,937,160 \text{ leke} \times 20\% = 987,032 \text{ TVSH}$  *qe duhej zbritur, nga kjo zbritur*  $520,000 \text{ leke TVSH}$  *ndaj vlerës*  $2,600,000 \text{ leke}$  *nga*  $4,937,160 \text{ qe duhej, pra diferenca}$   $4,937,160 - 2,600,000 = 2,337,160 \times 20\% = 467,032 \text{ leke}$ ).

**Sa sipër**, Ndryshe ka ndodhur me objektin “*Rikonstruksion shkolla Fierzë*”, sipas urdhër shpenzimit nr. 399 datë 24.12.2019, për subjektin V.nd. shpk, ku rezulton se në fund te situacionit është zbritur TVSH e pajisjeve të ngrohjes.

**Observacioni i subjektit** qëndron pjesërisht, pasi ka përlllogaritje gabim tek subjekti “V.Nd.shpk”, e cila u korrigjua dhe u reflektua ne projekt Raportin e Auditimit, ndërsa për rastin tjetër paraqitet dublim te vlerave 39,760 leke me subjektin “P.G.shpk”, e cila u korrigjua dhe u sistemua duke u reflektuar ne projekt Raportin e Auditimit.

5. Sipas urdhër shpenzimit nr. 90 datë 25.03.2019 është likuiduar vlera 16,092,927 lekë për subjektin fitues “J.shpk”, bazuar në faturën nr. 11 datë 28.09.2018 dhe situacionin të punimeve nr. 4 për objektin “**Ndërtim rrjetit shpërndarjes ujit pijshëm e restaurim depove ekzistuese ne bashkinë Fushë-Arrëz**”, rezultoi se:

Subjekti pjesërisht zërat “**Pajisjet e makineritë e ujit**” i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit. Për rrjedhojë tvsh është përfituar 2 herë, në moszbatim të kërkesave të udhëzimit nr. 2 datë 8.5.2003, çka përbën dëm ekonomik për vlerën **212,011 leke** ( $1,060,056 \times 20\% = 212,011 \text{ leke}$ , *Pajisjet si: kontator uji 4 lloje dhe 1 galexhant automatik DN 200*).

Po kështu është vepruar sipas urdhër shpenzimit nr. 91 datë 25.03.2019, faturës subjektit nr. 59 datë 08.03.2019 dhe situacionin të punimeve nr. 2, për objektin “*Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Iballe*”, ku zërat “Pajisjet e palestrës” i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, ku nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit.

**Sa sipër**, nga sektori i shërbimeve dhe i urbanistikes T.P. situacioni është firmosur pa kontrolluar zërat e “pajisjeve” ne mënyre analitike.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 868/3, datë 19.12.2021 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga strukturat e Bashkisë Fushë Arrëz ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:  
Pretendimet e subjektit: Konstatimi për tvsh e pajisjeve të përfituar dy herë nuk qëndron pasi nuk mund të verifikohet transaksioni i OE në blerjen e tyre, problematikë kjo e konfirmuar nga KLSH në raste të ngjashme më përpara dhe e konsultuar gjatë ballafaqimit.*

*Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni merret në konsideratë dhe u ezaurua në raportin përfundimtar të auditimit.*

*Shpenzime për mirëmbajtje rrugësh dhe për investime me mangësi në dokumentacion:*

7. Sipas urdhër shpenzimit nr. 215, datë 17.07.2019, është likuiduar subjekti “O.shpk” për vlerën 1,415,561 lekë, për mirëmbajtjen e rrugëve të bashkisë Fushë-Arrëz, rezulton se:

- mungon kërkesat e administratorëve të njëjësive për riparimin e pjesës të dëmtuar të rrugëve rurale,
- mungon fotografimi para dhe pas meremetimit të rrugëve me skicat e përmasuara, si dokument provë për efekt të justifikimit të vlerës së shpenzuar.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 08.07.2010 “*Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollit*” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 36.

8. Sipas urdhër shpenzimeve nr. 297, datë 21.10.2020 dhe nr. 307 date 04.11.2020 si dhe nr. 350 date 04.12.2020 është likuiduar subjekti “**L.shpk**” për vlerën 1,087,000 lekë (869,000 lekë + 120,000 leke + 98,000 leke), për shërbime ne 28,9 ha pyje Qafë Mali të bashkisë Fushë-Arrëz, sipas faturës dhe situacionit subjektit nr. 14 date 09.10.2020, kontratës nr. 1510 date 22.06.2020, rezulton:

- mungon ne faturën e subjektit nr. 14, date 09.10.2020, nënshkrimi i komisionit të marrjes dorëzim, **D.LI. specialist kadastre, M.M. administrator i njësisë Qafmali dhe G.V. specialist pyjesh** por është mjaftuar me firmën e titullarit.

- akt marrja ne dorëzim date 21.09.2020 e këtij komisioni paraqitet formale, pasi mungojnë te dhënat, konkretisht: mungon fotografimi para dhe pas pastrimit te drurëve ne sipërfaqen 28,9 ha pyje, mungon fletëhyrja e sasisë ne m<sup>3</sup> te druve stogje te pastruara dhe grumbulluara, ku janë hequr 10-15% e numrit drurëve ne pyll.

- mungon leja pyjore e subjektit për pastrim pyjesh.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 08.07.2010 “*Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollit*” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 36, ku thuhet: *dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime,*

9. Sipas urdhër shpenzimit nr. 289, datë 09.10.2019, është likuiduar situacioni nr. 2 përfundimtar i “*Ndërtimit bazamenteve te urave fshati Koprati dhe Micoj të fshatit Iballe*”, rezultoi se: Dokumentacioni nuk është i plotë, pasi:

- aktkolaudimi date 30.08.2019 është i parregullt, sepse i mungon vula,
- mungon licenca e kolaudatorit M.T.,
- mungon fotografimi, skicimet dhe përmasimi para dhe pas ndërtimit te bazamenteve te urave,
- mungon kërkesa e përgjegjësit shërbimeve të Bashkisë dhe kërkesa e administratorit Njësisë Iballe, për riparimin e pjesës të dëmtuar të bazamentit të 2 urave.

Ndryshe është vepruar me objektin “*Rikonstrukcion i kanalit Iballe*”, sipas urdhër shpenzimit nr. 199, datë 21.07.2020, ku pasqyrohet me fotografi para dhe pas rikuperimit kanalit, pra **kemi aplikim me 2 standarde.**

**Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim z. O.C., me detyrë Nënkyetar i Bashkisë, z. D.C. dhe z. N.M., me detyrë Administrator i NJA Iballë.**

Shpenzime për vendime gjyqësore

**Në 4 raste** për vitin 2019-2020 për **vlerën 4,998,642 lekë me ndikim negativ për buxhetin e shtetit**, Bashkia Fushë-Arrëz ka likuiduar **vendimet gjyqësore** Puke lëne ne fuqi nga Apeli të formës prerë, për:

\* Ne 2 raste për **largime nga puna** në mënyrë të paligjshme të punonjësve të bashkisë, duke krijuar dublim page për 1 vend pune.

\* Ne 1 rast për vonesa në likuidimin e subjektit nga ish-komuna Blerim.

\* Në 1 rast për 1 gjobë të vendosur nga AKU dhe likuiduar nga bashkia, në vend që të paguhej nga kuzhina e kopshtit Fushë Arrëz,

**Sa sipër, Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka analizuar dhe nxjerrë përgjegjësinë dhe nuk ka marrë masa administrative ndaj personave fajtor**, në kundërshtim me udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011” pika 6.1 “Vendimet gjyqësore” ku thuhet: *Institucionet analizojnë të gjitha vendimet që sjellin ndikim negativ për buxhetin e shtetit dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive, dhe duhet të ndjekin gjitha shkallet e gjyqësori, me pikën 62 e UMF 2 datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” ku thuhet se: “...Titullarët e njërive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative....”*

**Sa sipër**, më konkretisht sipas rasteve:

**10.** Sipas urdhër shpenzimit nr. 362, datë 22.11.2019 Bashkia Fushë-Arrëz ka likuiduar vlerën 62,000 lekë në adrese të zyrës Përmbarrimit *Strati*, për **gjobën e vendosur nga AKU ndaj kopshtit kuzhinës** Fushë-Arrëz.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 868/3, datë 19.12.2021 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga strukturat e Bashkisë Fushë Arrëz ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

*Pretendimet e subjektit: Në lidhje me gjobën e vendosur nga AKU ndaj kopshtit, kuzhinës në Fushë Arrëz gjoba është likuiduar nga Institucioni pasi pas analizës rezultoi se nuk ishte përgjegjësi e personelit të kuzhinës por e Bashkisë Fushë Arrëz.*

*Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni merret në konsideratë dhe u ezaurua në Raportin Përfundimtar të auditimit.*

**11.** Sipas urdhër shpenzimit nr. 363, datë 12.11.2019, nr. 211 date 05.08.2020, nr. 62 date 21.09.2020 etj. Bashkia Fushë-Arrëz ka likuiduar, në zbatim te vendimeve gjyqësore Puke datë 30.10.2017 lëne ne fuqi nga Apeli Shkodër datë 18.01.2018, për **largimin nga puna te punonjësit K.P.** si të pa ligjshëm, sipas shkresës përmbarrimore nr. 2164 datë 14.11.2018, për vënien ne sekuestro te vlerës **634,202 leke** nga *kjo 67,950 leke tarife përmbarrimore dhe 566,252 leke pala debitorë bashki.*

**12.** Sipas urdhër shpenzimit nr. 364, datë 22.11.2019, nr. 263 date 21.09.2020, nr. 349 date 03.12.2020 Bashkia Fushë-Arrëz ka likuiduar, në zbatim te vendimeve gjyqësore të shkallës parë Puke lëne ne fuqi nga Apeli Shkodër nr. 4022 date 09.11.2018, për **largimin nga puna te punonjësit K.Ll.** si të pa ligjshëm, sipas shkresës përmbarrimore nr. 386 datë 22.11.2019, për vënien ne sekuestro te vlerës **1,756,320 leke** nga *kjo 1,491,000 leke debitor bashkia dhe tarife përmbarrimore dhe 265,320 leke dhe kthimin ne pune.*

**13.** Sipas urdhër shpenzimit nr. 369, datë 17.12.2020 Bashkia Fushë-Arrëz ka likuiduar vlerën **2,546,120 leke** në zbatim te vendimeve gjyqësore Puke, për subjektin “**V.D.shpk**”, për **dëmshpërblim për vonesa ne pagimin e detyrimit kontraktor nga ish komuna Blerim**, sipas shkresës përmbarrimore nr. 12, datë 26.04.2016.

**14.** Nga auditimi u konstatua se dietat janë kryer në përputhje me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, përjashtuar 9 raste ku janë përfituar padrejtësisht dieta për vlerën 147,000 lekë dem ekonomik jashtë qarkut Puke, për periudhën e pandemisë të muajit Mars-Maj 2020, ku pagesa e shërbimeve është kryer vetëm për dietën ushqimore nën mungesën e faturës dhe kuponit tatimor të fjetjes në hotel.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 868/3, datë 19.12.2021 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga strukturat e Bashkisë Fushë Arrëz, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:  
Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni merret në konsideratë pasi mbështetet në argumente, prova dhe dokumente ligjore dhe u ezaurua në raportin përfundimtar të auditimit.*

**Titulli i gjetjes:** *Mungesë kontrolli për faturat e energjisë elektrike për ndriçimin rrugor përsa i përket taksës së televizionit shqiptar si dhe në praktikat dokumentare për mirëmbajtje rrugësh.*

**Situata:**

*Nga Bashkia Fushë-Arrëz, për periudhën e audituar, me veprimet e bankës, u konstatuan shkelje dhe mangësi me efekte financiare për vlerën **9,600 leke**, konkretisht:*

- ne 2 vitet 2019-2020 ka kryer padrejtësisht pagesën e taksës televizorit për 4 kontrata me OSHEE, duke shkaktuar një efekt negativ financiar 9,600 lekë,,
- ne 3 raste për vitin 2019-2020 u konstatuan mangësi në praktikat dokumentare për likuidimin e shpenzimeve për mirëmbajtje rrugësh.

**Kriteri:**

- udhëzimi nr. 2 datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”,
- VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”,
- ligjin nr. 10279, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollit”,
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,
- ligjin 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë”

**Impakti:**

*krijimi i efekteve negative financiare për vlerën 9,600 leke.*

**Shkaku:**

*Përgjegjësi e strukturave drejtuese dhe mos njohja e plotë e kuadrit ligjore.*

**Rëndësia:**

*I mesëm.*

**Rekomandimi:**

- Bashkia Fushë-Arrëz të ndjekë gjitha hapat ligjore për eliminimin dhe mos likuidimin e zërit “taksa e televizionit=100 leke/muaj” për 3 linjat e ndriçimit rrugor dhe 1 të tregut lire, të pasqyruar në faturat e OSHEE, pasi kjo vlerë është përfituar padrejtësisht.

**C.** Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

Ky drejtim auditimi do të jetë objekt i auditimit të ardhshëm në këtë bashki.



#### **C.4. Auditim për zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve;**

Referuar të dhënave të regjistrit të procedurave të prokurimit të zhvilluara për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020, konstatohet se në fushën e investimeve publike janë gjithsej 8 procedura me kontrata të përfunduara me vlerë kontrate 92,177,991 lekë pa tvsh, nga të cilat: për vitin 2019 janë 6 procedura me vlerë kontrate 78,628,248 lekë dhe për vitin 2020 janë 2 procedura me vlerë kontrate 13,549,743 lekë pa tvsh.

Mbi bazën e materialitetit dhe kohës në dispozicion, janë vlerësuar për auditimin nga grupi 2 procedura me vlerë kontrate **63,384,933** lekë pa TVSH ose 69% e kontratave të punëve publike të mbyllura.

#### **Nga auditimi i zbatimit të 2 kontratave u konstatua se:**

**1.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "*Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë*", *Fushë Arrëz*", konstatohet:

- Projekti parashikon ndërtimin e palestrës në shkollën "70 Vjetori i Pavarësisë", Fushë Arrëz. Ndërtimi i palestrës konsiston në plinta b/a, strukturë kolonash me soletë monolite e mbuluar me profile metalik në kapriadë dhe panele sanduiç. Projekti i palestër është realizuar nga shoqëria "2B. C." shpk, me përfaqësues Ing. U.K.. Objekti i kontratës "*Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë*", *Fushë Arrëz*" është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 2186 prot. datë 15.07.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Fushë Arrëz, përfaqësuar nga z. F.T. dhe Bashkimit të operatorëve ekonomik ose sipërmarrësit "P.G." shpk & "J." shpk përfaqësuar nga administratori i "P.G." z. U.P. Vlera e kontratës është 47,104,606 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 8 muaj nga data e fillimit të punimeve. Leja e ndërtimit është miratuar me nr. prot 1756/2 datë 03.07.2019, nr. 6 datë 03.07.2019, me sipërfaqe të zënë për ndërtim 458 m<sup>2</sup>. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar *nenit* 37 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.
- Për Mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 2405 prot. datë 02.08.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Fushë Arrëz, përfaqësuar nga z. F.T. dhe Operatorit Ekonomik "M.A.K S."shpk përfaqësuar nga administratori Ing. T.S. Për Kolaudimin e punimeve është kontraktuar operatorit ekonomik "N.S."shpk përfaqësuar nga administratori Ing. E.N. Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët datë 02.08.2019. Procesverbali i fillimit të punimeve, njoftimi i fillimit të punimeve nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi janë mbajtur nga palët datë 02.08.2019, bashkë me procesverbalin e pikeimit të objektit.
- Me kërkesën e mbikëqyrësit të punimeve nr. 4146 prot. datë 20.12.2019, drejtuar Bashkisë Fushë Arrëz, kërkohet ndryshimi i sistemit të ngrohjes, për arsyen e administrimit sa më efikas nga sistem VAV në sistem ngrohje me kaldaje me naftë me ngrohje aeroterma. Bashkëlidhur kësaj kërkesë mbikëqyrësi paraqet propozimit teknik, me preventivin e punimeve që zëvendësohen, analizat e çmimeve të reja dhe projektin e instalimit.
- Me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë nr. 4146/1 prot. datë 20.12.2019, drejtuar projektuesit të objektit "2B.C." shpk, mbi ndryshimet dhe propozimin teknik, ku kërkohet që ndryshimet të

realizohen brenda vlerës së kontratës. Me shkresën e projektuesit nr. 35 prot. datë 20.12.2019, konstatohet se propozimi i ndryshimit ka argumentim teknik dhe financiar për efektin e ndryshimeve të sistemit të ngrohjes dhe pranon ndryshimet e propozuara. Me procesverbalin e datës 19.12.2019, miratohen nga palët, zëvendësimi i zërave të punimeve që kanë të bëjnë me sistemin ngrohës VAV, bashkë me analizat e çmimeve. Analizat e çmimeve për zërat e rinj janë të tipit F.V "Furnizim Vendosje", ku në analizat e çmimeve janë parashikuar rakorderitë e ndryshme, shpenzime plotësuese 1 %, bashkë me shpenzime administrative ose plotësuese 8%. Tabela e lëvizjes së volumeve miratohet pas kërkesës së sipërmarrësit datë 18.12.2019, e cila përfshin edhe përdorimin e fondit rezervë prej 3 %. Amendimi nr. 1, me nr. 3107 datë 03.10.2019 i kontratës, është realizuar për zgjatje të afatit të punimeve deri më datë 29.04.2020, i miratuar nga palët, bazuar në shkresën e mbikëqyrësit datë 30.09.2019, për shkak të problemeve në spostimit të linjave të OSHEE.

- Amendimi nr. 2, me nr. 833 datë 31.03.2020 i kontratës, është realizuar për zgjatje të afatit të punimeve deri më datë 12.06.2020, i miratuar nga palët, bazuar në shkresën e mbikëqyrësit datë 20.02.2020, për shkak të ndërprerjes së punimeve dhe rifillimit të tyre nga temperaturat e ulëta.

- Me shkresën e mbikëqyrësit nr. 1430 prot. datë 12.06.2020, njoftohet se punimet kanë përfunduar, bashkë me procesverbalin e përfundimit të punimeve miratuar nga palët datë 12.06.2020, *brenda afateve kontraktuale të miratuara*. Procesverbali i kolaudimit është realizuar më datë 03.08.2020, ku citohet se objekti është për shfrytëzim. Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar më datë 12.08.2020. Nga verifikimi i projektit të rishikuar, konstatohet se mungojnë përllogaritjet e tabelave të hekurit për hekurin e betonit dhe të kapriadës, të cilat paraqesin risk në likuidimet mbi zërat e hekurit. Në tabelën e përllogaritjeve të profileve të kapriadës, konstatohen përllogaritje jo të sakta, të cilat *rrisikojnë përfitime të padrejta të sipërmarrësit*. Në profilet IPE 180, UNP 100, PL, L etj., ndryshojnë peshat specifike të profileve dhe nuk argumentohet sasia e kapriadës prej 23.6 Ton, ku në preventivin fillestar kanë qenë të parashikuara 13 Ton, pra një diferencë prej 10 Ton *1,886,000 lekë pa TVSH* e cila është e paargumentuar në përllogaritje, pasi projekti nuk ka pësuar ndryshime të kapriadës. *Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi të miratuara nga mbikëqyrësi Ing. T.S., si më poshtë vijon:*

**1.** Në kapitullin e punimeve B/A dhe sistemimeve, zëri nr. 14 "F.V bredha  $d > 10$  cm", janë likuiduar 58 copë. Libreza e masave pasqyron 58 copë dhe nga verifikimi në terren ishin të vendosura 25 copë ose 33 bredha më pak. Me çmimin përkatës prej 3,502 lek/copa, rezulton se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht vlerën prej **115,566 lekë pa TVSH**. **2.** Në kapitullin e punimeve B/A dhe sistemimeve, zëri nr. 14 "F.V fidanë dekorativë", janë likuiduar 43 copë. Libreza e masave pasqyron 43 copë dhe nga verifikimi në terren ishin të vendosura 23 copë ose 20 fidanë më pak. Me çmimin përkatës prej 10,000 lek/copa, rezulton se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht vlerën prej **200,000 lekë pa TVSH**. **3.** Në kapitullin e Instalimeve Hidrosanitare, zëri nr. 7 "F.V Rezervuar uji zingato 5000 litra", nga verifikimi në objekt u konstatua se rezervuari nuk ishte vendosur në objekt dhe në situacionin përfundimtar ky zë pune ishte likuiduar. Vlera e rezervuarit sipas ofertës është **110,000 lekë pa TVSH**, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi. **4.** Nga procesverbali i datës 19.12.2019, ku u zëvendësuan zërat e punimeve të sistemit ngrohës VAV, bashkë me analizat e çmimeve, zërat në rakorderitë e ndryshme, përbëjnë mbivendosje të zërave dhe proceseve të punës, *pasi vetë zërat e pajisjeve kanë patur të përfshirë rakorderitë*. Kapitulli i sistemit ngrohës/ftohës, konstatohet se zërat nga nr. 1 deri 19 janë F.V "Furnizim vendosje" si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sit. përf.	Çmimi	Vlera
-----	----------	--------	------------	-------	-------

1	F.V Aeroterm 25 kë + <b>Rakorderi</b>	cope	8	117,701	941,608
2	F.V Tub me presion Ø54 mm + <b>Rakorderi</b>	ml	80	2,914	233,120
3	F.V Tub me presion Ø42 mm + <b>Rakorderi</b>	ml	95	2,269	215,555
4	F.V Tub me presion Ø35 mm + <b>Rakorderi</b>	ml	55	1,921	105,655
5	F.V Tub me presion Ø28 mm + <b>Rakorderi</b>	ml	160	1,558	249,280
6	F.V Tub për radiatorët, multistat Ø16mm + <b>Rakorderi</b>	ml	170	541	91,970
7	F.V Tub për radiatorët, multistat Ø26mm + <b>Rakorderi</b>	ml	95	893	84,835
8	F.V Kaldaje 220 kë e kompletuar + <b>rakorderi</b> + <b>pajisje</b>	Komplet	1	889,715	889,715
9	<b>F.V Element radiatori alumini + Pajisje + Rakorderi</b>	Komplet	9	48,510	<b>436,590</b>
10	F.V pompe qarkulluese + <b>Rakorderi</b>	Komplet	1	189,029	189,029
11	F.V Oxhak kaldaje + <b>Rakorderi + Pajisje</b>	Komplet	1	59,858	59,858
12	F.V Depozite naftë + <b>Rakorderi</b>	cope	1	720,243	720,243
13	F.V Ventilator 2" + <b>Rakorderi</b>	cope	5	14,235	71,175
14	F.V Ajenxjerres + <b>Rakorderi</b>	cope	30	12,940	388,200
15	<b>F.V Rakorderi dhe materiale te ndryshme</b>	cope	30	10,767	<b>323,010</b>

Zërat "F.V Aeroterm, tubat me presion, radiatorët, kaldaja, pompa etj dhe të gjithë aksesorët e nevojshme për montim, përfshijnë materiale të ndryshme dhe rakorderitë. Konstatohen zëra pune të mbivendosur strukturës së ofertës së propozuar nga sipërmarrësi dhe të miratuara nga mbikëqyrësi, në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". Struktura e analizës e propozuar nga sipërmarrësi janë parashikuar të gjitha rakorderitë dhe përsëri vendosen në situacionin përfundimtar, duke e përfituar padrejtësisht zërin nr. 11 në situacion "F.V Element radiator alumini + Pajisje + Rakorderi", në vlerën **436,590 pa TVSH** dhe zërin nr. 17 të situacionit përfundimtar "F.V Rakorderi dhe materiale te ndryshme", në vlerën **323,010 lekë pa TVSH**, duke u përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Të gjitha ndryshimit dhe oferta e re e kontraktorit (me zëra të mbivendosur), ka pasur miratimin e Autoritetit Kontraktor, çka i ngarkon me përgjegjësi për shkelje të LPP në përzgjedhjen e kandidatit fitues dhe të nenit 35.1 "Negociatat dhe Amendamentet" ku citohet "Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshojë dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit". Ndryshimi i thellë i projektit nuk është kusht i nenit 36 të kontratës, pasi në rastin e kanalit nuk ka korrigjime të projektit por ndryshim rrënjësor.

Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet **vlera prej 1,185,166 lekë pa tvsh (115,566 + 200,000 + 110,000 + 436,590 + 323,010)**, e përfituar nga sipërmarrësi, për punime të pakryera dhe të mbivendosura. Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve Ing. T.S., nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit." Nga kolaudatori i punimeve Ing. E.N., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve” Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar. c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

- Në lidhje me observacionet e dërguara nga mbikëqyrësi i punime Ing. T.S., me nr. 46 prot. datë 14.10.2021, të protokolluara në Bashkinë Fushë Arrëz me nr. 2483 prot. Datë 14.10.2021, mbi pretendimet e pasaktësive, nuk merren në konsideratë pasi:

1. Në lidhje me zërin 11 “Konstruksione Metalike të përbëra”, ku pretendohet se për profilet UNP 100, IPE 180, ndryshojnë spesorët, nuk merret në konsideratë pasi profilet metalike UPN dhe IPE janë profile standarde me peshë specifike fikse.

2. Në lidhje me fidanët dhe bredhat, sqarojmë se në momentin e konstatimit nuk janë prezentë ku sipërmarrësi është likuiduar për atë sasi. Gjithashtu ju rikujtoj se bredhat duhet të ishin me diametër  $d > 10$  cm, dhe ato që ishin instaluar ishin me diametër  $d < 5$  cm.

3. Në lidhje me Rezervuarin e ujit 5000 L, nga dokumentacioni fotografik i vënë në dispozicion ku depozita ishte vendosur dhe pretendohet se është vjedhur pas dorëzimit të objektit, merret pjesërisht në konsideratë, por grupi auditimit gjykon bazuar konstatimit fizik në objekt e cila nuk ishte në objekt dhe sipërmarrësi është likuiduar për këtë rezervuar.

4. Në lidhje me sistemin ngrohës, pretendimet e mbikëqyrësit mbi ndryshimet dhe mbi mbivendosjen e rakorderive nuk merren në konsideratë, pasi edhe në observacionin bashkëlidhur konstatohet mbivendosja e rakorderive në Kg.

**Titulli i Gjetjes 1:** Pasaktësi në situacionin përfundimtar të objektit objektin “Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarsisë”, Fushë Arrëz ”.

**Situata:** Objekti i kontratës “Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarsisë”, Fushë Arrëz ” është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 2186 prot. datë 15.07.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Fushë Arrëz dhe Bashkimit të operatorëve ekonomik ose sipërmarrësit “P.G.” shpk & “J.” shpk. Vlera e kontratës është 47,104,606 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 8 muaj nga data e fillimit të punimeve. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi dhe në këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **1,185,166 pa TVSH**, e përfituar nga sipërmarrësi, për punime të pakryera dhe të mbivendosura, ku disa zëra punimesh mund të ishin korrigjohen në periudhën e garancisë së punimeve.

**Kriteri:** Situacioni përfundimtar jo në përputhje me projekt-preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3915 prot. datë 09.07.2019.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me nr. 3915/2 datë 09.07.2019.

**Ndikimi/Efekti:** Dëme ekonomike të paargumentuara në vlerën 1,185,166 lekë pa TVSH

**Shkaku:** Pasaktësi në situacionin përfundimtar për punime të pakryera dhe të mbivendosura.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandime:**

- Nga Bashkia Fushë Arrëz të marren masa që të rishikohen volumet e punimeve civile, të shoqërohen me librezat masash të sakta, në mënyrë që pagesat të argumentohen mbi bazën e volumeve të sakta.

- Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të paargumentuara në vlerën **1,185,166 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare, për arkëtimin e vlerës. (*Akt Konstatimi nr. 4, datë 08.10.2021*)

**2.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "**Rikonstruksioni i Kanalit Fshati Iballë, Nj. A. Iballë**", konstatohet:

- Projekti parashikon rehabilitimin e pjesëve të dëmtuara të kanalit në gjithë gjatësinë e tij, me veshje me beton, riparime muresh, plotësim vepra arti etj., për ti bërë funksional. Projekti i palestër është realizuar nga BOE "2B.C." shpk, & "HMK. me përfaqësues Ing. B.N.

- Objekti i kontratës "**Rikonstruksioni i Kanalit Fshati Iballë, Nj. A. Iballë**" është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 2378 prot. datë 31.07.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Fushë Arrëz, përfaqësuar nga z. F.T. dhe operatorit ekonomik ose sipërmarrësit "P.G." shpk përfaqësuar nga administratori z. U.P.. Vlera e kontratës është 28,957,314 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar **8 muaj** nga data e fillimit të punimeve. Leja e për punime është miratuar me nr. prot 2577 datë 21.08.2019, nga Kryetari i Bashkisë. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar *nenit 37* të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Për Mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 2548 prot. datë 16.08.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Fushë Arrëz, përfaqësuar nga z. F.T. dhe Operatorit Ekonomik "N."shpk përfaqësuar nga administratori Ing. E.N.

- Për Kolaudimin e punimeve është kontraktuar operatorit ekonomik "X.H.M."shpk përfaqësuar nga administratori Ing. Xh.D. Procesverbali i fillimit të punimeve, njoftimi i fillimit të punimeve nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi janë mbajtur nga palët me nr. 2577/2 prot. datë 21.08.2019, bashkë me procesverbalin e piktimit të objektit.

- Me kërkesën e sipërmarrësit datë 19.12.2019, kërkohet miratimi i ndryshimeve të punimeve që shtohen dhe hiqen. Me kërkesën e mbikëqyrësit të punimeve nr. 4159 prot. datë 19.12.2019, drejtuar Bashkisë Fushë Arrëz, kërkohen ndryshimet e objektit brenda vlerës së kontratës, duke përfshirë edhe fondin rezervë. Me procesverbalin e datës 19.12.2019, miratohet nga Investitori Bashkia Fushë Arrëz ndryshimet e projekt-preventivit. Nga verifikimi i tabelës së lëvizjeve të volumeve konstatohen ndryshime të mëdha të projektit, ku veshja me kanal është zbritur në sasi të konsiderueshme, bashkë me tubacionin e çelikut, ku janë rritur punimet e pamatshme të gërmimeve dhe është vendosur tubacion HDPE SN d=500mm. Veprime të cilat tregojnë për përfitime të padrejta të sipërmarrësit të punimeve pasi është tjetërsuar ose denaturuar projekti i zbatimit. Procedura e negociimeve për zërat e rinj ka marrë miratimet nga autoriteti kontraktur, ku çmimet e tubit HDPE SN d=500 mm janë më të ulëta se manuali i ndërtimit. Pra të gjitha ndryshimet kanë pasur miratimin e Autoritetit Kontraktor, çka i ngarkon me përgjegjësi për shkelje

të LPP në përzgjedhjen e kandidatit fitues dhe të nenit 35.1 "Negociatat dhe Amendamentet" ku citohet:

"Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshojë dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit". Ndryshimi i thellë i projektit nuk është kusht i nenit 36 të kontratës, pasi në rastin e kanalit nuk ka korrigjime të projektit por ndryshim rrënjësor. Me kërkesën e sipërmarrësit të punimeve datë 07.01.2020, kërkohet ndërprerja e punimeve për shkak të motit me borë, për një periudhë 54 ditore. Procesverbali i ndërprerjes së punimeve është mbajtur nga palët datë 07.01.2020. Rifillimi i punimeve është realizuar datë 02.03.2020. Me procesverbalin e miratuar nga palët datë 12.03.2020, punimet ndërpriten përsëri për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme të Covid-19 dhe rifillojnë më datë 28.03.2020. Me amendimin nr. 1 të kontratës nr. 900/1 prot. datë 15.04.2020, palët miratojnë shtyrje të afatit të punimeve deri më datë 15.07.2020. Njoftimi i përfundimit nga mbikëqyrësi është realizuar me shkresën nr. 1754 prot. datë 15.07.2020, bashkë me procesverbalin e përfundimit të punimeve, *brenda afateve kontraktuale*.

- Procesverbali i kolaudimit është realizuar më datë 12.10.2020, ku citohet se objekti është për shfrytëzim. Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar më datë 14.10.2020.

- Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, u konstatuan pasaktësi të miratuara nga mbikëqyrësi Ing. E.N., si më poshtë vijon:

1. Kontrata në preventivin e ripunuar, kapitullin e "Punime Dherash", zërat e gërmimit të dheut kanë pësuar ndryshime të thella të volumeve, në mënyrë të paargumentuar dhe pajustificuar bazuar në projektin e azhurnuar. Bazuar librezës së masave dhe projekt azhurnimit (As-Build), të miratuar nga mbikëqyrësi dhe të dorëzuara në Bashkinë Fush Arrëz, janë përshkruar sipërfaqet e profileve tërthore të piketave të kanalit, **të cilat nuk përputhen me llogaritjet e sipërfaqeve në librezat e masave**. Sipërfaqja e seksioneve tërthore janë përcaktuar me pajisje topografike GPS, duke nxjerrë kuotat e tokës, kuotat e projektit të zbatuar, sipërfaqen e gërmimit, sipërfaqen e mbushjes dhe gërmimin e rrugës. Pas verifikimit të profileve të seksioneve tërthore të projektit, vërehen sipërfaqeve tërthore **të pasakta në të gjitha seksionet**, duke rritur volumet e punimeve të kapitullit për punimet e dherave. Llogaritjet e gabuara të papërputhura janë në gjatësinë e kanalit, duke mos u përputhur me llogaritjet. *Tabela e mëposhtme pasqyron rritjet dhe ndryshimet e theksuara në gërmime ose 450 % më shumë, burim i marrë nga tabela e lëvizjes së volumeve.*

Nr.	Emërtimi I punimeve	Preventivi Baze				Preventivi I rishikuar		Punimet qe shtohen		% e rritjes së sasive
		Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Sasia	Vlera	Sasia	Vlera	
	II Punime dherash									
1	Gërmim kanalesh ne <b>toke te bute</b> me seksion deri 0.75	m3	410	160	65,600	947	151,555	537	85,955	231
2	Gërmim kanalesh ne <b>toke te forte</b> me seksion deri 0.75	m3	316	250	79,000	2,921	730,315	2,605	651,315	924
3	Gërmim dheu me ekskavator, ne kanale gjerësi >2 tok. zak	m3	1,810	160	289,600	11,242	1,798,672	9,432	1,509,072	621
4	Mbushje rrafshim ngjeshje me material gërmuar	m3	74	140	10,360	681	95,340	607	84,980	920
5	Rrafshim skarpate, me krahë ne toke zakonshme	m2	4,398	70	307,860	8,688	608,154	4,290	300,294	198
	<b>Vlera</b>				<b>752,420</b>		<b>3,384,036</b>		<b>2,631,616</b>	<b>450</b>

Nga auditimi në librezat e masave u konstatua se ***përlllogaritjet janë plotësisht të gabuara***, të cilat bien në kundërshtim me projektin e azhurnuar të krijuar nga sipërmarrësi dhe të miratuara nga mbikëqyrësi. Në tabelën e plus minuseve vlera e zbritur në kapitullin e betoneve për veshje kanali është pothuajse sa vlera e rritur në gërmime në 2,615,007 lekë pa TVSH. Pra ndryshimi i projekt-preventivit ka rezultuar në mos realizimin e kanalit me beton dhe vjeljen e vlerave në punimet e dherave. Gjithashtu është zbritur sasia e tubacionit të çelikut dhe vendosur zë i ri pune me tub HDPE. Si përfundim për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet **vlera prej 2,631,616 lekë pa TVSH e përfituar nga sipërmarrësi**, për rritje të volumeve të gërmimeve fiktivisht.

- Për sa më sipër, mbikëqyrësi i punimeve Ing. E.N., nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.” Nga kolaudatori i punimeve Ing. X.D., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve” Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar. c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

- Në lidhje me observacionet e dërguara nga mbikëqyrësi i punime Ing. E.N., me nr. 136 prot. datë 14.10.2021, të protokolluara në Bashkinë Fushë Arrëz me nr. 2484 prot. Datë 14.10.2021, mbi pretendimet e ndryshimeve të projektit, merren pjesërisht në konsideratë referuar problematikave të gabimeve të projektit, problematikave me banorët, me sezonin e vaditjes, etj.

- Në lidhje me pasaktësitë e projektit të azhurnuar në llogaritjes në librezën e masave, grupi i auditimit sqaron se midis sipërfaqeve të seksioneve tërthore të kanalit dhe llogaritjet në librezën e masave, ekzistonte një mospërputhshmëri e tyre, duke mos argumentuar saktë vlerën e likuiduar sipërmarrësit.

**Titulli i Gjetjes 2:** Pasaktësi në situacionin përfundimtar të objektit “***Rikonstruksioni i Kanalit Fshati Iballë, Nj. A. Iballë***”, Bashkia Fushë Arrëz.

**Situata:** Objekti i kontratës “***Rikonstruksioni i Kanalit Fshati Iballë, Nj. A. Iballë***” është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 2378 prot. datë 31.07.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Fushë Arrëz dhe operatorit ekonomik ose sipërmarrësit "P.G." shpk. Vlera e kontratës është 28,957,314 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 8 muaj nga data e fillimit të punimeve. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi dhe në këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **2,631,616 lekë pa TVSH**, e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 2835 prot. datë 27.05.2019
- Kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. 2835/2 datë 27.05.2019

**Ndikimi/Efekt:** Dëme ekonomike të pa argumentuara në vlerën 2,631,616 lekë pa TVSH .

**Shkaku:** Pasaktësi në situacionin përfundimtar për shkak të llogaritjeve të gabuara.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandime:** - Nga Bashkia Fushë Arrëz të marren masa që të rishikohen volumet e punimeve civile, të shoqërohen me profilet tërthorë e gjatësorë në librezat e masave, në mënyrë që pagesat të argumentohen mbi bazën e volumeve të sakta.

- Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të paargumentuara në vlerën **2,631,616 pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare, për arkëtimin e vlerës.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 868/3, datë 08.12.2021 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga operatori ekonomik “P.G.” shpk, në lidhje me trajtimin e zbatimit të kontratave “Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70- Vjetori i Pavarësisë” dhe kontrata “Rikonstruksioni i Kanalit Fshatit Iballë, NjA Iballë” me objeksionet si më poshtë:*

*Pretendimet e subjektit:*

- Me shkresën nr. 3104/1 prot. datë 03.12.2021, Bashkia Fushë Arrëz njofton OE “P.G.” shpk, për gjetjet e Projekt-Raportit, ku është kthyer përgjigje në Bashkinë Fushë Arrëz me nr. 343 prot. datë 06.12.2021 ku sipërmarrësi pretendon si më poshtë:

*1. Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70- Vjetori i Pavarësisë”*

- Zëri F.V bredha me  $d > 10$  cm, sipërmarrësi ka marrë përsipër që brenda periudhës së garancisë ti vendosë bredhat

- F.V Rezervuar uji zingato 5000 litra, sipërmarrësi angazhohet ta ri-blejë rezervuarin.

- Në lidhje me zërat e mbivendosura të aksesorëve dhe rakorderive, sipërmarrësi ka paraqitur analiza çmimesh, përlllogaritje në përqindje të rakorderive, duke marrë 3 oferta të tjera në treg mbi aksesorët dhe rakorderitë, duke mos e pranuar mbivendosjen e zërave.

*Qëndrimi i grupit të auditimit:*

*1. Në lidhje me sistemin ngrohës, pretendimet e sipërmarrësi mbi ndryshimet dhe mbi mbivendosjen e rakorderive merren pjesërisht në konsideratë bazuar dokumentacioneve të bashkëlidhura, ku sqarojmë gjithashtu se Bashkia është autoriteti i cili duhet të vlerësojë gjetjet e konstatuara të zërave të punimeve.*

*2. “Rikonstruksioni i Kanalit Fshatit Iballë, Nj.A Iballë”.*

*Sipërmarrësi ka konstatuar faktin se nuk përputhen profilet tërthorë të kanalit me librezat e masave, ku sqaron se kjo ka ndodhur për shkak të një “Lapsusi” apo gabimi njerëzor dhe në Bashki është paraqitur prerje tërthorë të gabuara. Pas verifikimeve dhe arsyetimeve të paraqitura palët bien dakord që të përlllogarisin përputhshmërinë midis librezave të masave me profilet e sakta.*



**3.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion me objekt "**Shërbime projektimi për projekte të financuara nga Bashkia Fushë-Arrëz, për vitin 2019**", konstatohet se në bazë të procedurës së prokurimit zhvilluar më datë 04.12.2019 në bazë të urdhrin të prokurimit Nr. 366/2, Datë 15.11.2019 me FL në shumën 7,034,166 lekë pa tvsh, është shpallur fitues i tenderit BOE "A.S." sh.p.k, "HMK." sh.p.k, "T.H.C." sh.p.k, i përfaqësuar nga "A.S." sh.p.k dhe ka lidhur kontratën me AK me Nr. 4199, datë 26.12.2019 në shumën 6,401,091 lekë pa tvsh dhe në shumën 7,681,309 lekë me tvsh për shërbime projektimi për projektet:

1-Shërbim projektimi me objekt "Sistemim asfaltim ndriçim i hapësirave të gjelbëra në rrugën Rinia qyteti Fushë Arrëz me FL 467,000 lekë.

2- Shërbim projektimi me objekt "Ndërtim rrjetit të plotë të ujësjellësit të ri në fshatin Kryezi me FL 3,622,500 lekë.

3- Shërbim projektimi me objekt "Sistemim, rrethim gjelbërim varrezave publike në qytetin Fushë Arrëz me FL 291,660 lekë.

4- Shërbim projektimi me objekt "Rindërtimi i mureve mbajtëse të shesheve të pallateve në qytetin Fushë Arrëz me FL 510,000 lekë.

5- Shërbim projektimi me objekt "Hapje traseje rruge autopërroi Bugjon Fshati Aprripe Guri Njësia Fierzë me FL 1,522,500 lekë

6- Shërbim projektimi me objekt "Projekt për shkollën 9-vjecare Blerim, Njësia Blerim, me FL 620,800 lekë.

Afati i projektimit dhe dorëzimi i projekteve duhet të realizohet për 25 ditë, duke filluar në datën e lidhjes së kontratës 26.12.2019 dhe të dorëzohen tek AK në datën 25.01.2020.

Nga auditimi rezulton se projektet janë marrë në dorëzim te afatit të përcaktuar në kontratë. Në bazë të procesverbalit të marrjes në dorëzim të datës 04.08.2020 nga Komisioni i pritjes së mallit për vitin 2020 i përbërë nga O.Ç., P.L. dhe F.P. i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 43, datë 10.02.2020, i ndryshuar, janë marrë në dorëzim projektet, janë bërë hyrje në institucion në bazë të fletëhyrjes nr. 10, datë 04.08.2020 dhe dalje tek zyra e urbanistikës me fletëdalje nr. 117, datë 31.08.2020.

Në bazë të kontratës sa më sipër me Nr. 4199, datë 26.12.2019 për çdo ditë vonesë për dorëzimin e mallit BOE "A.S." sh.p.k, "HMK." sh.p.k, "T.H.C." sh.p.k duhet të penalizohet me shumën 4/1000 të vlerës së kontratës. Duke llogaritur vonesën në zbatimin e kontratës nga data 10.02.2020 deri në datën 04.08.2020 penaliteti llogaritet si më poshtë:

-Ditë vonese 174 ditë.

-Vlera e kontratës 6,401,091 lekë pa tvsh.

-Penaliteti ditor 4/1000 x 6,401,091 lekë = 25,604 lekë.

-Penaliteti për ditët te afatit të zbatimit të kontratës 174 ditë x 25,604 = 4,455,096 lekë.

Përsa më sipër mban përgjegjësi Sektori i Financës, z. D.L., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Sektori Juridik, z. L.Nd., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik.

**Titulli i Gjetjes 3:** Mosdorëzim në afat të projekteve nga sipërmarrësi sipas kontratës me objekt "**Shërbime projektimi për projekte të financuara nga Bashkia Fushë-Arrëz, për vitin 2019**", Bashkia Fushë Arrëz.

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion me objekt "Shërbime projektimi për projekte të financuara nga Bashkia Fushë-Arrëz, për vitin 2019", konstatohet se në bazë të procedurës së prokurimit zhvilluar më datë 04.12.2019 në bazë të urdhrin të prokurimit Nr. 366/2, Datë 15.11.2019 me FL në shumën 7,034,166 lekë pa tvsh, është shpallur fitues i tenderit BOE "A.S." sh.p.k, "HMK." sh.p.k, "T.H.C." sh.p.k, i përfaqësuar nga "A.S." sh.p.k dhe ka lidhur

kontratën me AK me Nr. 4199, datë 26.12.2019 në shumën 6,401,091 lekë pa tvsh dhe në shumën 7,681,309 lekë me tvsh për shërbime projektimi për 6 projekte për infrastrukturë të Bashkisë Fushë Arrëz. Afati i projektimit dhe dorëzimi i projekteve duhet të realizohet për 25 ditë, duke filluar në datën e lidhjes së kontratës 26.12.2019 dhe të dorëzohen tek AK në datën 25.01.2020.

Nga auditimi rezulton se projektet janë marrë në dorëzim tej afatit të përcaktuar në kontratë për të cilën duhet të llogaritet penaltet sipas kontratës në shumën **4,455,096 lekë**.

**Kriteri:** Termat e kontratës me AK me Nr. 4199, datë 26.12.2019.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesë të ardhurash nga mosaplikimi i penalteteve sa më sipër.

**Shkaku:** Mungesë monitorimi i zbatimit të kontratës dhe mos adresim i kushteve të saj.

**Rëndësia:** E Lartë.

**Rekomandime:** - Autoriteti Kontraktor, Bashkia Fushë Arrëz, të formojë një grup pune me specialistë të fushës për të verifikuar dorëzimin real të projekteve dhe përputhshmërinë me aktet e mbajtura me BOE sipërmarrës për të evidentuar arsyet e mos përfundimit në afat të kontratës, përgjegjësitë respektive dhe marrjen e masave për zbatimin e kontratës për penaltet në shumën **4,455,096 lekë** ndaj sipërmarrësit të realizimit të projekteve.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 868/3, datë 08.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga z. T.P. me objeksionet si më poshtë:*

*Pretendimet e subjektit: Pretendohet se projektet janë marrë në dorëzim në afatin e përcaktuar.*

*Qëndrimi i grupit të auditimit: Në trajtimin e problematikës sa më sipër ka shërbyer si bazë procesverbali i marrjes në dorëzim të projekteve, fletëhyrja në magazinë dhe fletëdalja nga magazina për urbanistikën. Në observacion nuk provohet me fakte e prova e kundërta dhe në këto kushte observacioni nuk merret në konsideratë.*

**4.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion me objekt "**Ndërtim i mureve mbajtës te pallateve ne Qytetin Fushe-Arrëz (Faza I-re)**", konstatohet se në bazë të procedurës së prokurimit zhvilluar më datë 14.10.2020 në bazë të urdhrin të prokurimit Nr. 303, Datë 30.09.2020 me FL në shumën 11,666,666 lekë pa tvsh, është shpallur fitues i tenderit OE " U. ", sh.p.k, dhe ka lidhur kontratën me AK me Nr. 2884, datë 13.11.2020 në shumën 11,550,008 lekë pa tvsh dhe në shumën 13,860,010 lekë me tvsh. Mbikëqyrës i punimeve "G.L." sh.p.k. me Drejtues Teknik & Ligjor Ing. G.S.

Afati i përfundimit të punimeve është parashikuar tre muaj nga data e lidhjes së kontratës 13.11.2020. Punimet duhej të dorëzoheshin në datën 11.02.2021.

Në datën 02.12.2020, " U.", sh.p.k, raporton të kryera 67% të punimeve dhe bazuar në situacionin nr. 1 është likuiduar nga AK fatura nr. 19, datë 02.12.2020 në bazë të UP nr. 358&359 datë 11.12.2020 në shumë totale me tvsh 9,235,356 lekë (4,620,000+4,615,356). Nga ky moment " U.", sh.p.k, ka ndërprerë punimet dhe nuk ka asnjë njoftim apo korrespondencë zyrtare me AK dhe deri në datën 08.10.2021 që përfundoi auditimi në terren, OE "U.", sh.p.k, nuk është paraqitur për përfundimin e punimeve megjithë interesimin e Zyrës së Urbanistikës sipas ballafaqimit.

Në bazë të kontratës sa më sipër me Nr. 2884, datë 13.11.2020, neni 34, pika 34.1,a) për çdo ditë vonesë për përfundimin e punimeve dhe dorëzimin "U.", sh.p.k, duhet të penalizohet me shumën 4/1000 të vlerës së mbetur të kontratës minimalisht mbi 25% të shumës së kontratës. Duke llogaritur vonesën në zbatimin e kontratës nga data 12.02.2021 deri në datën 08.10.2021 penalteti llogaritet në shumën si më poshtë:

-Ditë vonese 240 ditë.

-Vlera e kontratës 13,860,010 lekë me tvsh, vlera e mbetur 13,860,010-9,235,356=4,624,654 lek.

-Penaliteti ditor 4/1000 x 4,624,654 lekë = 18,499 lekë.

-Penaliteti për ditët tej afatit të zbatimit të kontratës 240 ditë x 18,499 lekë = 4,439,667 lekë.

Përsa më sipër mban përgjegjësi Mbikëqyrësi i Punimeve, Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Titullari i AK.

**Titulli i Gjetjes 4:** Mos përfundim i punimeve dhe mos dorëzim në afat nga sipërmarrësi sipas kontratës me objekt “Ndërtim i mureve mbajtës te pallateve ne Qytetin Fushe-Arrëz (Faza I-re)”, Bashkia Fushë Arrëz.

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion me objekt “Ndërtim i mureve mbajtës te pallateve ne Qytetin Fushe-Arrëz (Faza I-re)”, konstatohet se në bazë të procedurës së prokurimit zhvilluar më datë 14.10.2020 në bazë të urdhrin të prokurimit Nr. 303, Datë 30.09.2020 me FL në shumën 11,666,666 lekë pa tvsh, është shpallur fitues i tenderit OE "U.", sh.p.k, dhe ka lidhur kontratën me AK me Nr. 2884, datë 13.11.2020 në shumën 11,550,008 lekë pa tvsh dhe në shumën 13,860,010 lekë me tvsh. Mbikëqyrësi i punimeve “G.L.” sh.p.k. Afati i përfundimit të punimeve është parashikuar tre muaj nga data e lidhjes së kontratës 13.11.2020. Punimet duhej të dorëzoheshin në datën 11.02.2021. Në datën 02.12.2020, "U.", sh.p.k, raporton të kryera 67% të punimeve dhe bazuar në situacionin nr. 1 është likuiduar nga AK fatura nr. 19, datë 02.12.2020 në bazë të UP nr. 358&359 datë 11.12.2020 në shumë totale me tvsh 9,235,356 lekë (4,620,000+4,615,356). Nga ky moment "U.", sh.p.k, ka ndërprerë punimet dhe nuk ka asnjë njoftim apo korrespondencë zyrtare me AK dhe deri në datën 08.10.2021 që përfundoi auditimi në terren, OE "U.", sh.p.k, nuk është paraqitur për përfundimin e punimeve. Në bazë të kontratës sa më sipër me Nr. 2884, datë 13.11.2020, neni 34, pika 34.1,a) për çdo ditë vonesë për përfundimin e punimeve dhe dorëzimin "U.", sh.p.k, duhet të penalizohet me shumën 4/1000 të vlerës së mbetur të kontratës minimalisht mbi 25% të shumës së kontratës. Duke llogaritur vonesën në zbatimin e kontratës nga data 12.02.2021 deri në datën 08.10.2021 penaliteti llogaritet në shumën 4,439,667 lekë.

**Kriteri:** Termat e kontratës me AK me Nr. 2884, datë 13.11.2020.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesë të ardhurash nga mos aplikimi i penaliteteve sa më sipër.

**Shkaku:** Mungesë monitorimi i zbatimit të kontratës dhe mos adresim i kushteve të saj.

**Rëndësia:** E Lartë.

**Rekomandime:** Autoriteti Kontraktor, Bashkia Fushë Arrëz, të formojë një grup pune me specialistë të fushës për të verifikuar evidencën në dosjen teknike të objektit përfshi korrespondencën dhe komunikimin me drejtuesin teknik të punimeve dhe mbikëqyrësin për të evidentuar arsyet e mos përfundimit në afat të veprës, përgjegjësitë respektive dhe marrjen e masave për zbatimin e kontratës dhe marrjen e masave respektive për përfundimin dhe marrjen në dorëzim të veprës sipas kontratës.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 868/3, datë 08.12.2021 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z. T.P. dhe z. D.L., me objeksionet si më poshtë:*

*Pretendimet e subjektit: Në lidhje me procedurën e trajtuar më sipër janë paraqitur dokumente, prova dhe fakte të cilat administroheshin në dosjen e subjektit pasi objekti nuk kishte përfunduar dhe marrë në dorëzim.*

*Qëndrimi i grupit të auditimit: Në këto kushte observacioni merret në konsideratë dhe është ezauruar në raportin përfundimtar të auditimit.*

#### **D. Të ndryshme të dala gjatë auditimit**

Nga auditimi u konstatua se në drejtim të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh, nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut, nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i tyre. Është hartuar Rregullorja e funksionimit të Njesisë, e miratur me Vendimin e Kryetarit nr. 1797/1, datë 26.07.2017 pjesë e së cilës është edhe kodi i etikës, por në të nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprime me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njesisë.

Në Bashkinë Fushë-Arrëz gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen pak. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Rezulton se nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut sipas nenit 21 të ligjit për MFK. Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

NJAB në ushtrimin dhe realizimin e funksionit të saj është bazuar në ligjin organik të AB, në Manualin e AB dhe në standardet e auditimit, por pavarësisht kësaj në auditimet e ushtruara nuk ka vlerësuar si duhet riskun në fushat e auditimit që janë me risk më të lartë si fusha e prokurimeve, planifikimit dhe realizimit të të ardhurave dhe e administrim-menaxhim i aseteve pronë e bashkisë për të cilat nuk janë zhvilluar auditime të thelluara. Gjithashtu nuk ka nxjerrje përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2019 – 2021 me shkresë nr. 3387, datë 16.10.2018 dhe, për vitet 2020-2022 me shkresë nr. 3319, datë 24.10.2019. Planet sa më sipër nuk janë përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6, sepse mungon pjesa përshkuese e këtij plani. Planifikimet vjetore të auditimeve për vitin 2019, dhe 2020 edhe pse janë përgatitur rregullisht, ata nuk janë përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2, sepse mungon pjesa përshkuese e këtij planifikimi. Nuk janë çelur dosjet e përhershme për çdo njësi publike të audituar, për ti shërbyer auditimit pasardhës, veprim që bie në kundërshtim me MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6.3

Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike janë mbajtur e plotësuar në përputhje me kërkesat e MAB, por administrimi i tyre nuk është bërë në përputhje me ligjin 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, sepse ato nuk janë arkivuar në arkivin e njesisë.

Nga subjektet e audituara nuk ka informacione (Plane veprimi) në lidhje me pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve dhe në përgjithsi rekomandimet nuk janë zbatuar nga subjektet që i janë nënështuar procesit të auditit të brendshëm në kundërshtim me ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se nga NJAB, nuk kishte program të sigurimit të cilësisë, dhe nuk rezultojë të kishte vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë së AB, në kundërshtim me Kap. VII, pika 7.1, 71.1, 7.2, dhe 7.2.1 të MAB.

Në mungesë të planeve strategjike të njësisë, afatmeseme apo afatshkurtëra dhe planeve periodike të aktiviteteve u identifikuan objektivat e njësisë nga procesi i përgatitjes së PBA dhe buxheteve vjetore si më poshtë:

- Përmirësimi i strukturës së shërbimeve publike
  - Përmirësimi i strukturës mbështetëse të arsimit parashkollor dhe të mesëm
  - Përmirësimi i strukturës së shërbimeve të rrugëve rurale
  - Përmirësimi i strukturës së administrimit pyjor
  - Përmirësimi i strukturës së mbrojtjes nga zjarri
  - Përmirësimi i menaxhimit të njësisve shpenzuese në varësi të bashkisë
  - Ruajtjen e vazhdimësisë së kryerjes së investimeve të planifikuara
  - Përmirësimin e të ardhurave të veta të bashkisë nëpërmjet planifikimit analitik të tyre
  - Mbatjes nën kontroll të shpenzimeve për çdo njësi shpenzuese
  - Rritjes së kontrollit mbi territorin
  - Politikat në fushën e investimeve synojnë kryerjen e investimeve në funksion të rritjes ekonomike, rritje e cilësisë së shërbimeve dhe zgjerimit të tyre të cilat do të mundësohen nëpërmjet:
  - Financimit të investimeve kapitale
  - Përmirësimin të shërbimit të gjelbërimit dhe ndriçimit të qytetit
  - Paraqitjes së projekteve për përmirësimin e infrastrukturës së qytetit dhe aplikimin tel FZHR.
- Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit me shkresë nr. 56, datë 30.05.2020 rezulton se është zbatuar pjesërisht dhe në proces plani i veprimit i njësisë raportuar në KLSH me shkresë nr. 1393/2, datë 25.06.2020. Nga 17 masa të vlerësuara, tre masa nuk janë zbatuar, 8 masa janë zbatuar, dy masa janë në proces gjyqësor, 1 masë është kompetencë e institucionit të kadastrës dhe të tjerat janë në proces.
- Sa trajtuar më sipër nuk përputhen plotësisht me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 06.11.2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, VKM nr. 212, datë 30.03.2012, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësisve të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, MAB, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016, “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi për vitin 2019 dhe 2020 i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të Bashkisë Fushë-Arrëz, konstatohet se:

-Të ardhurat në total dhe në zëra analitike paraqesin mosrealizime dhe grafiku i tyre është në rënie krahasuar me vitin 2019, konkretisht:

\*Të ardhurat për vitin 2019 janë realizuar 84 % ose në vlerë absolute 22 milion lekë nga 26 milion lekë të planifikuara.

\*Të ardhurat për vitin 2020 janë realizuar 61 % ose në vlerë absolute 16 milion lekë nga 26 milion lekë të planifikuara, pra diferenca 6 milion leke më pak nga viti 2019.

Përsa trajtuar më lart nuk përputhet me planifikimin në PBA dhe buxhetet vjetore të miratuara. Mos realizimet kanë ardhur si pasojë e ndikimit të faktorëve objektiv më së shumti por dhe subjektiv nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz.

*( Më hollësisht trajtuar në faqet 29-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Fushë-Arrëz të marrë masa për planifikimin e saktë dhe në përputhje me mundësitë objektive të saj si dhe për realizimin e të ardhurave vendore, financiare dhe tjera, në zbatim të paketës fiskale të miratuar në KB, të kërkesave ligjore dhe buxhetit të miratuar.

*Në vazhdimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi për vitin 2019-2020, në Bashkinë Fushë-Arrëz ka fatura të pa likuiduara në vlerën totale **3,410,092 lekë**, sipas bilancit 2020, që i përkasin shpenzimeve për energji elektrike, fatura ujësjellësi, likuidim interneti, poste, ushqimet për kopësht çerdhe si dhe shpenzime investimesh në 4 raste, ku për këta të fundit ministria e linjës që ka financuar projektet nuk ka buxhetuar realizimin e plotë të këtyre objekteve të investimeve të cilat nuk përputhen me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit ( Më hollësisht trajtuar në faqen 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi** Bashkia Fushë-Arrëz të planifikojë në buxhetin e vitit 2022 fonde për likuidimin në radhë të parë të faturave të subjekteve të pa likuiduara në vlerën totale 3,410,092 lekë, dhe më pas faturat e radhës të vitit ushtrimor.

*Në vazhdimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi për vitin 2019-2020 konstatohet se janë likuiduar **vendime gjyqësore për vlerën 3,995,202 lekë (bashke me tarifat përmbartimore), me ndikim negativ në buxhetin e shtetit**, për dublim page për të njëjtin vend pune si rezultat i largimeve nga puna të 4 punonjësve, ndërsa Bashkia Fushë-Arrëz **nuk ka nxjerrë përgjegjësinë dhe nuk ka marrë masa administrative ndaj personave fajtor**, në kundërshtim me pikën 62 të UMF nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit ( Më hollësisht trajtuar në faqen 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Fushë-Arrëz:

- të analizojë përgjegjësitë administrative ndaj personave përgjegjës, të cilët kanë larguar në mënyrë të paligjshme 4 ish-punonjësit e bashkisë, sipas vendimeve të gjykatës, pasi kanë shkaktuar efekte negative në buxhet për vlerën 3,995,202 lekë shpenzime gjyqësore.
- të analizohet dhe të nxirret përgjegjësia për shkaktimin e vlerës 1,003,440 lekë shpenzime përmbartimore, për sanksione nga vonesat në likuidimin e 4 vendimeve gjykatës.

*Në vazhdimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe performancës të vitit 2020 të Bashkisë Fushë Arrëz konstatohet se bilanci 2020 nuk mbahej në një nga versionet e programeve kompjuterike Alfa 5 (*financa 5*), në ndryshim nga ajo që është mbajtur në përgjigje të standardeve bashkëkohore. ( *Më hollësisht trajtuar në faqen 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës Bashkisë Fushë-Arrëz për vitet në vazhdim të implementojë mbajtjen e bilancit në një nga versionet e programeve kompjuterike Alfa 5 (*financa 5*), në përgjigje të standardeve bashkëkohore.

*Në vazhdimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në pasqyrat financiare të vitit **2020 paraqitet llogaria “debitor të ndryshëm” për vlerën 271,246,057 lekë**, për 23 subjekte fizike e juridike për detyrime të prapambetura kontraktuale dhe rekomandime të KLSH si dhe ndaj 97 personave për detyrime të ndryshme për taksa e tatime të pashlyera ndaj bashkisë të mbartura në vite. Bashkia Fushë Arrëz nuk ka dërguar urdhrat e bllokimit në adresë të bankave të nivelit të dytë për detyrimet e subjekteve debitorë, nëpërmjet protokollit sipas ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë. ( *Më hollësisht trajtuar në faqen 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës, Bashkia Fushë-Arrëz, të marrë masa për sistemimin e llogarisë “*debitor të ndryshëm*” për vlerën **271,246,057 lekë**, konkretisht:

-Të hartojë dhe miratojë program me afate të përcaktuara, për vjeljen e llogaria “*debitor të ndryshëm*”, për 23 subjekte fizike e juridike dhe 97 persona për detyrime për taksa e tatime të pashlyera prapambetura si dhe rekomandime të KLSH.

-Të dërgojë nëpërmjet protokollit urdhrat e bllokimit në adresë të bankave të nivelit të dytë për subjektet debitorë.

*Në vazhdimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimeve të bankës për vitin 2019 dhe 2020 u konstatua se në faturat e OSHEE është shtuar si zë shpenzimi taksa e televizorit për 3 linjat e ndriçimit rrugor dhe 1 të tregut libre, çka ka shkaktuar një *efekt negativ financiar 9,600 lekë*, duke rënduar padrejtësisht shpenzimet e institucionit, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, date 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” neni 9, pika 4, neni 12 pika 3. ( *Më hollësisht trajtuar në faqen 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1. Rekomandimi:** Zyra juridike në bashkëpunim me zyrën e financës Bashkia Fushë-Arrëz të ndjekë të gjitha hapat ligjore për eliminimin dhe mos likuidimin e zërit “*taksa e televizorit=100 leke/muaj*” për 3 linjat e ndriçimit rrugor dhe 1 të tregut libre, të pasqyruar në faturat e OSHEE, pasi kjo vlerë është përfituar nga OSHEE padrejtësisht.

*Në vazhdimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Në 3 raste u konstatuan të meta dhe mangësi në praktikën dokumentare, për mirëmbajtje rrugësh, pastrim pyjesh dhe investim urash në fshatrat e bashkisë, pasi mungon në faturën e subjektit nënshkrimi i komisionit të marrjes dorëzim, mungon vula dhe licenca e kolaudatorit në aktin e kolaudimit, mungon fotografimi, skicimet dhe përmasimi para dhe pas meremetimit dhe ndërtimit të objekteve, mungon kërkesa e përgjegjës të shërbimeve të bashkisë dhe kërkesa e administratorit të njësive, për riparimin e pjesës të dëmtuar të veprave infrastrukturës si dhe akt marrjet në dorëzim paraqiten formale me të dhëna cinguar, çka ka ndikuar në argumentimin e shpenzimeve të kryera, sipas urdhër shpenzimeve nr. 215, datë 17.07.2019, nr. 297, datë 21.10.2020, nr. 289, datë 09.10.2019, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 08.07.2010 “*Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollit*”, pika 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik. ( Më hollësisht trajtuar në faqen 37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*).

**7.1. Rekomandimi:** Zyra e shërbimeve, urbanistikes dhe financës Bashkia Fushë-Arrëz të kompletojë dokumentacionin për meremetimin dhe rikonstruksionin e veprave infrastrukturës, për efekt të argumentimit tyre,.

*Në vazhdimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Grupi për Menaxhimin Strategjik nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, kërkesë e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF Plotësues nr. 8, datë 29.3.2012 “Procedurat e përgatitjes të buxhetit afatmesëm”, Kap. V; Struktura e raportit për funksionimin e SKB për vitet 2019, dhe 2020, nuk është në përputhje me shtojcën nr. 2, të Udhëzimit të MFE nr. 28, datë 15.12.2011 si dhe nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” pika 40, dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, neni 4 pika 19 “*Gjurma e auditimit*” dhe neni 16 pika 2 (Më hollësisht trajtuar në faqet 90-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartohet e miratohet Plani Strategjik dhe aktivitetet të detajuara për realizimin e objektivave të përcaktuara në strategji, dokumentacioni të përgatitet në përputhje me kuadrin ligjor, kryesisht duke ruajtur hapat sipas gjurmës së auditimit ekonomik e financiar të miratuar nga Titullari i Bashkisë Fushë Arrëz.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Plani Strategjik edhe pse është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Politikave dhe Auditit të Brendshëm për vitet 2017-2019, nuk është përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6, sepse mungon pjesa përshkuese e këtij plani.



- Planifikimet vjetore të auditimeve për vitin 2017 dhe 2018, edhe pse janë përgatitur rregullisht, ata nuk janë përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2, pasi mungon pjesa përshkruese e këtij planifikimi si dhe nuk janë çelur dosjet e përhershme për çdo njësi të audituar, për ti shërbyer auditimit pasardhës, veprim në kundërshtim me Manualin e Auditit të Brendshëm, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.

Dosjet koherente të auditimit të brendshëm janë mbajtur e plotësuar në përputhje me kërkesat e MAB por administrimi i tyre nuk është bërë në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, sepse ato nuk janë arkivuar në zyrë-arkivin e njësisë (*Më hollësisht trajtuar në faqet 90-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**9.1. Rekomandimi:** Plani strategjik, planifikimi vjetor, si dhe gjithë dokumentacioni tjetër i nevojshëm në procesin auditues të NjAB, të përpilohen në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditit të Brendshëm si dhe të bëhet praktikë pune çelja e dosjeve të përhershme për çdo njësi të audituar duke i pasuruar ato me materiale nga auditimet e reja, me qëllim që kjo ti shërbej auditimeve pasardhëse të njësisë. Nga NjAB pas përfundimit të auditimit të brendshëm të njësisë të bashkisë, të kryhet inventarizimi i dosjes koherente për çdo auditim, dhe të arkivohen ato në zyrë arkivin e Bashkisë Fushë Arrëz.

*Në vazhdimësi*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, nga **Titullari i Njësisë Publike**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit. **Nëpunësi Zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **8,271,878 lekë** ndaj **subjekteve**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të objektit "Ndërtim i palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 70-Vjetori i Pavarësisë", Fushë Arrëz " të kryer sipas kontratës për punë publike nr. 2186 prot. datë 15.07.2019, të lidhur midis Bashkisë Fushë Arrëz dhe sipërmarrësit "P.G." shpk & "J." shpk, me vlerë të kontratës 47,104,606 lekë me TVSH, dhe afat zbatimi 8 muaj nga data e fillimit të punimeve rezultoi se: nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi dhe në këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 1,185,166 pa TVSH, e përfituar nga sipërmarrësi, për punime të pakryera dhe të mbivendosura, ku disa zëra punimesh mund të ishin korigjuar në periudhën e garancisë së punimeve. (*Më hollësisht trajtuar në faqet 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

### **1.1. Rekomandim:**

- Nga Bashkia Fushë Arrëz të merren masa që të rishikohen volumet e punimeve civile, të shoqërohen me librezat masash të sakta, në mënyrë që pagesat të argumentohen mbi bazën e volumeve të sakta.

- Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të paargumentuara në vlerën 1,185,166 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare, për arkëtimin e vlerës.

### **Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Objekti i kontratës “Rikonstruksioni i Kanalit Fshati Iballë, Nj. A. Iballë ” është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 2378 prot. datë 31.07.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Fushë Arrëz dhe operatorit ekonomik ose sipërmarrësit "P.G." shpk. Vlera e kontratës është 28,957,314 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 8 muaj nga data e fillimit të punimeve. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi dhe në këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 2,631,616 lekë pa TVSH, e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara. (Më hollësisht trajtuar në faqet 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

### **2.1. Rekomandim:**

- Nga Bashkia Fushë Arrëz të merren masa që të rishikohen volumet e punimeve civile, të shoqërohen me profilet tërthore e gjatësore në librezat e masave, në mënyrë që pagesat të argumentohen mbi bazën e volumeve të sakta.

- Bashkia Fushë Arrëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të paargumentuara në vlerën 2,631,616 pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare, për arkëtimin e vlerës.

### **Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion me objekt "Shërbime projektimi për projekte të financuara nga Bashkia Fushë-Arrëz", për vitin 2019", konstatohet se në bazë të procedurës së prokurimit zhvilluar më datë 04.12.2019 në bazë të urdhrit të prokurimit nr. 366/2, datë 15.11.2019 me fondin limit në shumën 7,034,166 lekë pa tvsh, është shpallur fitues i tenderit BOE “A.S.” sh.p.k, "HMK." sh.p.k , "T.H.C." sh.p.k, i përfaqësuar nga “A.S.” sh.p.k dhe ka lidhur kontratën me Autoritetin Kontraktor me nr. 4199, datë 26.12.2019 në shumën 6,401,091 lekë pa tvsh dhe në shumën 7,681,309 lekë me tvsh për shërbime projektimi për 6 projekte. Afati i projektimit dhe dorëzimi i projekteve është 25 ditë, duke filluar në datën e lidhjes së kontratës 26.12.2019 deri në datën 25.01.2020.

Nga auditimi rezulton se projektet janë marrë në dorëzim tej afatit të përcaktuar në kontratë. Në bazë të procesverbalit të marrjes në dorëzim të datës 04.08.2020 nga Komisioni i pritjes së mallit për vitin 2020 i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 43, datë 10.02.2020, i ndryshuar, janë marrë në dorëzim projektet, janë bërë hyrje në institucion në bazë të fletëhyrjes nr. 10, datë 04.08.2020 dhe dalje tek zyra e urbanistikës me fletëdalje nr. 117, datë 31.08.2020.

Në bazë të kontratës sa më sipër për çdo ditë vonesë për dorëzimin e mallit BOE "A.S." sh.p.k, "HMK." sh.p.k, "T.H.C." sh.p.k duhet të penalizohet me shumën 4/1000 të vlerës së kontratës. Duke llogaritur vonesën në zbatimin e kontratës nga data 10.02.2020 deri në datën 04.08.2020 penalteti llogaritet në shumën 4,455,096 lekë. (Më hollësisht trajtuar në faqet 80-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**3.1. Rekomandim:** Autoriteti Kontraktor, Bashkia Fushë Arrëz, të formojë një grup pune me specialistë të fushës për të verifikuar dorëzimin real të projekteve dhe përputhshmërinë me aktet e mbajtura me BOE sipërmarrës për të evidentuar arsyet e mos përfundimit në afat të kontratës, përgjegjësitë respektive dhe marrjen e masave për zbatimin e kontratës për penaltet në shumën 4,455,096 lekë ndaj sipërmarrësit të realizimit të projekteve.

#### **D. MASA DISIPLINORE:**

##### **D/1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", gjerat (b, c, ç) e nenin 58-"Llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz që t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.7.2019 deri më 31.12.2020, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për **6 (gjashtë) punonjës**, si më poshtë:

*"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", neni 58 germa (c)"*

**1. Zj. S.M.**, me Detyrë Speciliste e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve, për sa më poshtë vijon:

-Për mosveprim në verifikimin e të drejtave të Bashkisë Fushë Arrëz në raport me OSHEE mbi faturimin e taksës për TVSH në linjat e ndriçimit rrugor, trajtuar në f. 29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**2. Z. D.L.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës, për sa më poshtë vijon:

-Për mosveprim në verifikimin e të drejtave të Bashkisë Fushë Arrëz në raport me OSHEE mbi faturimin e taksës për TVSH në linjat e ndriçimit rrugor, trajtuar në f. 29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Për mungesë kontrolli të realizimit të kontratave për punë, mallra e shërbime përpara se të ekzekutohet likuidimi i tyre në lidhje me termat e kontratës përsa i përket penalteteve për dorëzimin tej afatit të përcaktuar në kontratë.

**3. Z. T.P.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikim-Territorit, për sa më poshtë vijon:

-Për veprime dhe mosveprime në verifikimin e TVSH për makineri e pajisje të cilat mund të jenë përfituar dy herë nga OE pjesëmarrës në punët dhe shërbimet publike, B. Fushë Arrëz, trajtuar në f. 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **D/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz**, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2019 deri më 31.12.2020, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për **2 (dy) punonjës**, si më poshtë:

##### **“Vërejtje me paralajmërim”, neni 13.3 i kontratës individuale.**

**1. z. L.Nd.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik, për sa më poshtë vijon:

-Për mosveprim në verifikimin e të drejtave të Bashkisë Fushë Arrëz në raport me OSHEE mbi faturimin e taksës për TVSH në linjat e ndriçimit rrugor, trajtuar në f. 29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Për mungesë kontrolli të realizimit të kontratave për punë, mallra e shërbime përpara se të ekzekutohet likuidimi i tyre në lidhje me termat e kontratës përse i përket penaliteteve për dorëzimin tej afatit të përcaktuar në kontratë.

**2. z. Nd.M.**, me detyrë Administrator NJA Iballë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes së punëve, shërbimeve dhe mallrave në dorëzim për mos kontroll të dokumentacionit para marrjes në dorëzim të objektit “Rikonstruksioni i kanalit Iballë “trajtuar në faqen 32 të Raportit Përfundimtar të auditimit.

**D/3.** Për të gjithë punonjësit tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masë disiplinore konkrete, i lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë dhe Komisionit Disiplinor, marrja e masave ligjore e procedurale për vijimin e procedurave disiplinore në referim të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM-së nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale.

#### **E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore) pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, *të ndërmarrë veprimet si më poshtë:*

**1.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.*

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**